



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 387/6 prot.

Tiranë, më 11.10.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Afrim Shehu
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.9.2024, është njoftuar vendimi nr. 762, datë 15.5.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu, me detyrë prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.9.2024, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 30.9.2024, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Afrim Shehu, ushtron aktualisht detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Shehu, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Afrim Shehu”², ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **AKSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit³, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim *** Shehu”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit *Raportin*⁴ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.

3. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, ka arsyetuar si vijon:

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.1.2019.

³ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë **.10.2017. Deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. **, datë **.1.2023.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.10.2023.

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë:** [...] Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitet. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Afrim Shehu, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016[...].

3.2 **Për kontrollin e figurës:** [...] Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Formulari i deklarimit për figurën është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimeve të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 [...]

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale:** [...] Në analizë të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016. [...]

4. Vendimi i Komisionit. Komisioni, nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁵ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 30.9.2024, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, ndaj vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu.

5.1 Vëzhguesuesit ndërkombëtarë, nëpërmjet aktit “Rekomandim për paraqitje ankimi” çmojnë se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ në Komision, së bashku me gjetje të tjera që mund të rezultojnë gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në një vlerësim të drejtë të të gjithë elementeve, do të çojnë në vendim të ndryshëm nga ai i Komisionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë vlerësojnë se disa çështje, nuk janë vlerësuar si duhet nga Komisioni, duke e bërë vendimin të paqartë dhe të pabazuar në aktet në dosje, në kundërshtim me praktikën e Komisionit dhe parimet e jurisprudencës së vendosur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë rekomandojnë një shqyrtim gjyqësor në tërësi të çështjes, duke u përqëndruar për sa do të trajtohet në vijim (rekomandim bashkëlidhur dhe pjesë e këtij ankimi).

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 762/2024, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe

⁵ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

10. Për sa më sipër, *Komisioneri Publik*, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 762/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

11. Pasuri nr. 1, Apartament me sipërfaqe 72,20 m², ndodhur në rrugën “**”**

11.1 Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 72,20 m², me adresë në rrugën “****”, regjistruar në ZK ****, me nr. */****+*_****, vol. **, fq. ****. Janë depozituar: Kontratë sipërmarrje datë **.5.2003, kontratë shitje nr.*** rep., nr.***/* kol, datë **.7.2010, si dhe likujduar me këste sipas mandat arkëtimeve nr. **, datë **.9.2003, nr. ** datë, **.9.2005 dhe nr. **, datë **.5.2008. *Burimi i krijimit*: Të ardhurat nga paga si Oficer i Policisë Gjyqësore ndër vite dhe si avokat **.4.2002 - **.12.2003, dhe një vlerë prej 10.041 euro dhuratë nga **** (vëllai), me banim në Londër, Angli, të depozituara datë **.7.2003 në llogarinë në emër të Afrim Shehu, pranë **** Bank, Tiranë. *Vlera*: 4.000.000 lekë. *Pjesa takuese*: 100%.

11.1.1 Në rubrikën “Të Dhëna Konfidenciale” të kësaj deklarate, subjekti ka detajuar: “**** (vëllai), i biri i ****, i datëlindjes **.4.1974, lindur në ****, Mat dhe banues në Londër dhuratë në datë **.9.2003, në vlerën 10.041 euro dhe në datë **.5.2008 në vlerën 2.500 paund. *Burimi*: Të ardhura në puna fushën e ndërtimit, nga viti 1999 e në vazhdim.

11.2 Në *Deklarimin e vitit 2004* (dorëzuar në **.3.2005), në funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes dhe as pagesën e kështit të parë.

11.3 Në *Deklaratën e Interesave Private para Fillimit të Detyrës të vitit 2009* (dorëzuar në **.12.2009), në funksionin e prokurorit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament banimi në Rr.”****”, nr.*, kati *, shkalla *, me sipërfaqe 83,7 m². Kontrata e sipërmarrjes dt.**.5.2003 e lidhur me shoqërinë ndërtuese “****”. *Vlera*: 22.589 dollarë. *Pjesa takuese*: 100%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë.

11.4 Lidhur me origjinën e pronësisë së apartamentit, janë administruar kontrata e sipërmarrjes e datës **.5.2003⁶ për apartamentin me sip. 83,7 m² në rrugën “****”, Tiranë, si dhe kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. ***/* kol, datë **.7.2010, për apartamentin me sip. 72,2 m², në shumën 4.000.000 lekë, me palë shitëse shoqëria “**** sh.p.k. dhe palë blerëse z. Afrim Shehu, ku përcaktohet se vlera është likujduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, si dhe janë administruar kopje të 3 mandat arkëtimeve të subjektit në arkën e shoqërisë, respektivisht: mandat nr.**, datë **.9.2003 për arkëtimin e shumës 9.040 usd me përshkrimin “*pagesë kësti*

⁶ Kjo kontratë është nënshkruar midis sipërmarrëse shoqëria “**** sh.p.k dhe porositësit z. Afrim Shehu., të cilët bien dakort se: “Sipërmarrësi merr përsipër të ndërtoj apartamentin në godinën shumëkatëshe në Rr. **** dhe ti dorëzoj porositësit të përfunduar apartamentin nr.*, kati *, shkalla *, me sipërfaqe 83,7 m². Çmimi i apartamentit është 270 \$/m²...Pagesa do bëhet ... 40 % e vlerës do të paguhet në momentin e lidhjes së kësaj kontrate, 9.040 \$, 50 % e vlerës do të paguhet në momentin kur të përfundoj objekti si karabina, 10 % e vlerës do të paguhet në momentin kur të përfundojnë të gjitha punimet dhe apartamenti të jetë gati për banim”.

për ap.e prenotuar në Rr.*** *** Tiranë”; mandat nr. **, datë **.9.2005 për arkëtimin e shumës 10.000 usd me përshkrimin “pagesë kësti ap.Rr.*** *** Tiranë”; mandat nr. **, datë **.5.2008 për arkëtimin e shumës 3.960 usd me përshkrimin “pagesë përfundimtare për apartamentin në *** *** Tiranë”.

11.5 Në dosje gjithashtu rezulton e administruar edhe një deklaratë e thjeshtë e datës **.9.2004, nënshkruar nga z. ***,***, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., i cili deklaron se [...]Vlera e apartamentit sipas marrëveshjes me z. Afrim Shehu është në vlerën 270 usd/m² dhe vlera totale 23.000 usd. Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes...kam pranuar kërkesat e klientëve që kërkuan punime shtesë ... përkundrejt një pagese shtesë... Një ndër këta klientë është dhe z. Afrim Shehu, ku vlera e përlogaritur si rezultat i diferencës në çmimet për njësi në zërat e punimeve...është 1.270.000 lekë, shumë e cila do të pasqyrohet në kontratën përfundimtare të shitjes[...].

11.6 Në lidhje me shpenzimet për mobilimin të pasurisë, në përgjigje të pyetësorit nr.1 të Komisionit, subjekti ka deklaruar [...]Për mobilimin e këtij apartamenti dhe disa punimeve shtesë në lidhje me cilësinë e punimeve të brendshme si pllakat, dyert, dritaret, arredimin, pajisjet elektroshtëpiake dhe kondicioner për ngrohje janë shpenzuar 1.270.000 lekë. Punimet e brendshme, pllakat, dyert, dritare dhe arredimi janë bërë nga shoqëria ***[...].

11.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...]Ndryshimi midis çmimit të vlerës së apartamentit në kontratën e porosisë dhe çmimit të tij në kontratën e shitjes, ka ndodhur për shkak të disa punimeve shtesë dhe arredimit, të kryera dhe të vërtetuara si të kryera nga shoqëria “****” sh.p.k... Me mandatin e datës **.10.2005 është shlyer vlera e punimeve shtesë prej 1.270.000 lekë[...], duke depozituar edhe aktin “Kthim përgjigje e kërkesës së datës **.5.2023” nga “****” sh.p.k.⁷, në të cilën, administratori i shoqërisë deklaron se [...]sipas marrëveshjes verbale me ju, është rënë dakort që nga ana jonë të kryhej dhe arredimi i këtij apartamenti dhe nga ana jonë është arreduar, ku është shpenzuar një vlerë 239.130 lekë...Pra vlera e paguar nga ana juaj është 23.000 usd, punimet shtesë në vlerën 1.270.000 lekë, arredimi në vlerë 239.000 lekë. Pra apartamenti juaj është shitur në vlerën 4.000.000 lekë, e cila është pasqyruar në kontratën e shitjes[...]⁸.

11.8 Lidhur me burimin e këstit të parë në vlerën 9.040 usd, paguar në **.9.2003. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...]Saktësoj se si burim për pagesën e kryer sipas mandatit të arkëtimit datë **.09.2003, me vlerë 9.040 USD, ka shërbyer një pjesë e vlerës së huasë së marrë Cash në vlerën 4.000 dollarë në muajin gusht të vitit 2003 nga z. *** *** dhe pjesa tjetër janë të ardhura nga paga ime si Oficer i Policisë Gjyqësore, si avokat, si dhe nga shpërblimet për punë jashtë orarit në zyrën e avokatisë dhe të noterisë, si dhe një pjesë e kursimeve të cilat i kisha nga puna në emigracion. Deklarimi si

⁷ Shkresa kthim përgjigjeje të datës **.5.2023, lëshuar nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k.

⁸ Shoqëria ka depozituar edhe: (i) mandat arkëtimi i datës **.10.2005, për pagesën e shumës 1.270.000 lekë me përshkrimin “Për punime shtesë (të papërfshira) në kontratën sipërmarrjes për prenotimin e ap.nr. *, kt. *, shkalla *, në objektin me leje ndërtimi nr. **, dt.**.10.2002”; (ii) situacion punimesh nr. *, në të cilin janë përshkruar zërat e punimeve shtesë në vlerën 1.270.000 lekë; (iii) situacion punimesh përfundimtar në të cilin janë përshkruar zërat e punimeve të arredimit për kompletim kuzhine në vlerën 239.000 lekë.

burim i vlerës 10.041 euro, si dhuratë nga z. *** ** (vëllai im) ka qenë një pasaktësi e imja, në mënyrën se si unë kam lexuar dhe interpretuar të dhënat e statmentit bankar[...].

11.8.1 Në lidhje me huanë e sipërcituar, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar [...]kam marrë borxh (hua) nga shtetasi *** **, me shtetësi Angleze dhe banim në Londër, i cili është bashkëjetues me mbesën time *** **. Vlera e huasë ka qenë 23.000 Dollarë. Kjo hua është shlyer sipas datave të përshkruara në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën Vetting. Për shkak të marrëdhënies familjare është rënë dakort që borxhi (huaja) të formalizohej me kontratë huaje nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.09.2005 me shtetasin *** **, kunati im dhe vjehri i shtetasit *** **. Vlera e huasë është marrë në Cash, 4.000 dollarë në muajin gusht të vitit 2003 dhe vlera 15.296 euro në muajin tetor 2005 nëpërmjet bankës *** Bank (aktualisht *** Bank). Të dy vlerat e mësipërme janë konvertuar dhe është rënë dakort që kontrata të bëhej në monedhën dollarë në vlerën 23.000 dollarë. Huaja është kthyer pjesë pjesë, duke ia dhënë nipit tim *** **, djalit të *** **, i cili jetonte në Shqipëri në atë periudhë, siç kam deklaruar në deklaratimet periodike dhe në deklaratën Vetting. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të shtetasit *** **. (huadhënës) janë të ardhurat nga puna e tij në Londër[...].

11.8.2 Gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa akte: (a) kontratë huaje të datës **.9.2005, me palë huadhënëse z. *** ** dhe palë huamarrëse *** ** (bashkëshortja e subjektit), për shumën 23.000 usd, me afat kthimi 10 vjeçar⁹; (b) Pasaportë e z. *** **; (c) Dokumentacion shoqëruar për të ardhurat e z.*** **. për vitet 1999-2017.

11.8.3 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit të lidhur, në Deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, e ka deklaruar këtë hua si një nga burimet e një pasurie tjetër, apartament me sip.103 m² në rr. “*** **”, (sikundër do të trajtohet në vijim).

11.9 Lidhur me burimin e deklaruar: Të ardhura nga paga si OPGJ ndër vite dhe si avokat **.4.2002 - **.12.2003, ka rezultuar se në dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së, janë administruar: (a) Vërtetim i datës **.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku konfirmohen pagesat si OPGJ të subjektit për periudhën Tetor 1999 deri në Dhjetor 2000; (b)Vërtetim nënshkruar nga Av.*** **. (vëllai i subjektit), datë **.1.2017, i cili konfirmon punësimin si avokat të subjektit për periudhën **.4.2002- **.12.2003, [...]paguar me një pagë neto 55.000 lekë në muaj, për periudhën Prill 2002-dhjetor 2003 paguar një pagë neto 1.118.333 lekë dhe paguar shpërblime dhe punë jashtë orari në vlerën neto 1.400.000 lekë[...]; (c) Kontratë pune e datës **.4.2002, nënshkruar nga Av. *** ** në cilësinë e punëdhënësit dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e punëmarrësit¹⁰; (d) Vërtetim i ISSH-së për Bazën e Vlerësueshme dhe Pagën Neto Mesatare për periudhën Prill 2002 deri **.12.2003, ku paga bruto është 55.000 lekë.

⁹ Në kontratën e huasë citohet se: “Neni 1/Qëllimi i kontratës është sanksionimi i një marrëveshje ndërmjet z.*** **, i cili i jep një sasi mjetesh monetare hua znj. *** ** e cila i merr këttë sasi mjetesh monetare me detyrimin për ti kthyer; Neni 3/Huamarrësi *** ** merr këtë sasi mjetesh monetare në shumën 23.000 usd me detyrimin për ti kthyer brenda një afati 10 vjecar, dhe shlyerje me këste 2.300 usd/vit”.

¹⁰ Në nenin 4 të kontratës citohet: “Paga mujore neto që Punëdhënësi i njeh Punëmarrësit, për kryerjen e detyrave të përcaktuara... do të jetë 55.000 lekë...Punëmarrësi, do të shpërblehet me 20% të vlerës së paguar nga klientët e mbrojtur prej tij, si dhe në rastet e punës jashtë orarit dhe ditëve të pushimit, do të ketë shpërblime të tjera mbi pagën e përshkruar më sipër”.

11.9.1 Në lidhje me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e tjera, të deklaruar në vlerën totale 1.400.000 lekë (si komisione, punë jashtë orarit, shpërblime, etj), subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit ndër të tjera ka deklaruar [...]Nga shtetasit ***, ***, (vëllai) dhe ***, ***, (nusia e vëllait) më është lëshuar një deklaratë noteriale me nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.05.2023, të cilët kanë konfirmuar se unë kam punuar dhe më është paguar kjo vlerë duke paguar dhe detyrime tatimore. Si dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e tyre më është vënë në dispozicion, vërtetim me nr. ***, datë **.08.2006 i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se ***,*** me NIPT *** ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002, për një xhiro vjetore në vlerën 2.000.000 lekë dhe në vitin 2003 për një xhiro vjetore në vlerën 1.860.000 lekë. Dokumenti vërtetim me nr. ***, datë **.06.2006 i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se znj. ***, *** me NIPT *** për vitin 2002 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7.860.400 lekë dhe për vitin 2003 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7.700.000 lekë. Pra, siç kanë deklaruar avokati dhe noteri, detyrimet tatimore për të ardhurat e tjera “komisione, punë jashtë orarit, shpërblime, etj, që janë deklaruar nga ana ime në vlerën totale 1.400.000 lekë” janë paguar detyrimet tatimore nga studio ligjore e avokatisë dhe e noterisë[...]¹¹.

11.9.2 Bazuar në aktet në dosje, Komisioni në analizën financiare ka përfshirë vetëm të ardhurat nga paga të konfirmuara nga vërtetimi i ISSH-së me vlerë totale 956.340 lekë. Në lidhje me vlerën e deklaruar prej 1.400.000 lekë, e cila përfaqëson të ardhurat nga shpërblimet dhe orët jashtë orarit, Komisioni ka arsyetuar se nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti¹² rezulton se qarkullimi i deklaruar nga z.***.*** në vitin 2002 ka qenë 2.000.000 lekë dhe në vitin 2003 prej 1.800.000 lekë, kështu që rezulton e pamundur që me qarkullimin e deklaruar nga ky subjekt tregtar të gjenerohej vlera 1.400.000 lekë si shpërblim dhe orë jashtë orarit për subjektin e rivlerësimit gjatë viteve 2002-2003. Subjektit gjatë hetimit ka deklaruar se kjo vlerë është përfituar edhe nga puna pranë zyrës së noterisë së shtetasës ***,***., por pa paraqitur dokumenta provues.

11.9.3 Për sa më sipër, Komisioni nuk ka përfshirë si të ardhur të ligjshme në analizën e kryer prej tij, as shumën prej 1.400.000 lekë dhe as huan e deklaruar marrë në gusht 2003 prej shtetasit ***, ***. me vlerë 4.000 usd, pasi subjekti e ka deklaruar si burim vetëm gjatë hetimit administrativ.

11.10 Lidhur me burimet e deklaruara për pagesën e këstit të dytë në vlerën 10.000 usd në datë 13.9.2005, këstit të tretë në vlerën 1.270.000 lekë në datë 2.10.2005 dhe pagesat cash për mobilimin, në vlerën 239.000 lekë¹³, nga hetimi administrativ, ka rezultuar:

¹¹ Subjekti i bashkëlidh përgjigjeve: (i)deklaratë noteriale e shtetasve ***,***. dhe ***,***. me nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.5.2023, ku deklarohet se subjekti i rivlerësimit për periudhën **.4.2002-**.12.2003 ka punuar pranë zyrave të tyre (avokatisë dhe noterisë). Për shërbimet juridike shtesë, si dhe për rastet e punës jashtë orarit dhe në ditët e pushimit për këtë periudhë është shpërblyer në masën 1.400.000 lekë; (ii) vërtetim nr. ***, datë **.08.2006 i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se z. ***,*** me NIPT *** ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002 dhe 2003; (iii) vërtetim me nr. ***, datë **.06.2006 i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se znj. ***,*** me NIPT *** ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002 dhe 2003.

¹² Bashkëlidhur pyetësor nr. 2.

¹³ Subjekti deklaroi me pyetësor nr. 2 se ka filluar të jetojë në këtë apartament pas lidhjes së martesës me bashkëshorten tij në dt. **.07.2005. Pra, në analizën e tij komisioni i ka llogaritur shpenzimet për mobilim të kryera përpara se subjekti të fillonte të jetonte në të.

11.10.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar [...] *Si burim për shlyerjen e këstit të datës **09.2005 në vlerën 10.000 usd ka shërbyer dhurata e ardhur në datë **04.2004 me vlerë 7.000 euro nga vëllai im *** dhe në datë *09.2004 me vlerë 5.740 euro. Diferenca e kësaj vlere, së bashku me të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes *** dhe kursime të tjera që kisha nga puna si avokat (përfshirë dhe shpërblimet dhe punë jashtë orarit), kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të përshkruara në mandatin e datës **10.2005 për punimet shtesë prej 1.270.000 lekë, si dhe për arredim dhe kompletim guzhine në vlerën 239.000 lekë*. Në vazhdim të këtij pyetësi, subjekti ka deklaruar se: *“Nga data **05.1993 deri në datë **09.1995 kam qenë emigrant në Greqi dhe kam fituar të ardhura në vlerën 2.000.000 lekë. Me mua ka qenë dhe vëllai tjetër *** **, i cilinë Maj të vitit 1999, ai është nisur për në Angli, me motrën *** dhe fëmijët e saj *** dhe ***. Duke qenë se i duheshin të ardhura për shpenzimet e udhëtimit, i kam dhënë unë vlerën 1.000.000 lekë që e kisha gjendje nga të ardhurat e fituara në Greqi. Pasi ka shkuar në Angli, më ka dërguar para në datë **04.2004 vlerën 7.000 euro, më datë **09.2004 vlerën 5.740 euro dhe në datë **5.2008 vlerën 2.500 GBP[...]”¹⁴.*

11.10.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit pranë *** Bank kanë rezultuar transfertat ndërkombëtare në hyrje me përshkrimin *“Nga Mr. ***. *** _Receipt of International MT”* përkatësisht: (i) shuma 7.000 euro në dt. **4.2004 (tërhequr *cash* në dt. **4.2004); (ii) shuma 5.760 euro në dt. **9.2004, (tërhequr *cash* në dt. **9.2004).

11.10.3 Komisioni ka konstatuar se z. *** ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumat e mësipërme, por ato nuk janë përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë apartament në rrugën *“****”*, pasi në D-Vetting subjekti ka deklaruar si burim krijimi vlerën prej 10.041 euro, e cila rezultoi nga hetimi se nuk është transfertë e kryer nga vëllai, por depozitë kursimi e subjektit.

11.11 *Lidhur me burimin e këstit të fundit në shumën prej 3.960 usd, paguar në datë **5.2008, në D-Vetting (fq.8), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Nga vëllai në Angli (*** **) në formë dhuratë, datë **9.2003, kaluar në llogarinë në *** Bank dhe më datë **5.2008 kaluar në llogarinë në GBP *** Bank. *** ** që prej vitit 1999 jeton dhe banon në Londër (Angli). 10.041 euro datë **9.2003, 2500 GBP datë **5.2008”.*

11.11.1 Nga pasqyra e lëvizjeve të llogarisë pranë *** bank rezulton se në dt. **5.2008 është transferuar shuma 2.500 GBP me përshkrim *“kalim nga ***”*, e cila është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datë **12.2008.

11.11.2 Komisioni ka konstatuar se personi tjetër i lidhur, shtetasi *** **, kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme vlerën prej 2.500 GBP, por nuk e ka përfshirë në analizën financiare si burim për pagesën e fundit të apartamentit në rrugën *“****”*, pasi subjekti e ka tërhequr këtë shumë, pas shlyerjes së këstit të fundit.

11.12 Në përfundim për këtë pasuri, Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka konstatuar:

¹⁴ Për të provuar të ardhurat e shtetasit *** ** në Mbretërinë e Bashkuar subjekti ka paraqitur dokumentet HM të ardhurat dhe doganat që nga viti 2001 me nr. Ref: **, të vërtetuara me vulë Apostile në Mbretërinë e Bashkuar.

[...]Duket se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë, burimet e shlyerjes së kështit të parë duke deklaruar në deklaratën vetting se shuma është transferuar nga vëllai i tij **** ***, ndërsa nga dokumentacioni nuk rezulton se këto pagesa kanë patur këtë burim; Sa më lart duket se subjekti ka patur pamundësi financiare për të kryer pagesat për apartamentin në vlerën – 3.844.008 lekë¹⁵[...].

11.13 Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar konstatimet e Komisionit si dhe ka vënë në dispozicion akte për të provuar pretendimet e tij¹⁶.

11.14 Komisioni, në përfundim, në analizë të propësimeve dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, lidhur me këtë pasuri, ka vlerësuar se [...] Komisioni, në përmbledhje të sa trajtuar për pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “**** **”, me rezultatet e hetimit i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit në shumën totale - 3.844.008 lekë, por pas përcjelljes së parashtimeve dhe gjatë seancës dëgjimore subjekti arriti të shpjegojë në mënyrë shteruese, bindëse dhe të mbështetur në dokumentacion, duke e reduktuar pamundësinë financiare për këtë pasuri vetëm në vlerën e kështit të parë prej - 982.558 lekë¹⁷ [...].

11.15 Komisioneri Publik, për sa më sipër trajtuar, lidhur me burimet e ligjshme të pasurisë apartament banimi ndodhur në Tiranë me adresë rruga “**** **”, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, sa vijon:

11.15.1 Për sa i përket burimit: Të ardhura nga puna si avokat përgjatë periudhës **.4.2002- **.12.2003, deklaruar në D.-Vetting në shumën 2.518.333 lekë dhe në Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2009 në shumën 2.500.000 lekë, ndërsa nga shkresa e ISSH-së datës **.12.2017 konfirmohet se të ardhurat nga paga neto, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, pranë zyrës së avokatisë janë në shumën 409.860 leke në 2002 dhe 546.480 lekë në 2003.

11.15.2 Përsa i përket shumës 1.400.000 lekë, deklaruar përfituar si shpërblime dhe punë jashtë orari në vlerën neto, që i korrespondon 20% të fitimit, sipas vërtetimit të datës **.1.2017 nënshkruar nga av. ****.***. (vëllai i subjektit), Komisioneri Publik vlerëson se bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit mbi qarkullimin/xhiron e deklaruar nga zyra e avokatisë të vëllait të tij, ka rezultuar se në vitin 2002 xhiro ishte 2.000.000 lekë dhe në vitin 2003 xhiro ishte 1.800.000 lekë, kështu që shuma e pretenduar prej 20% të fitimit (sipas kontratës) do të rezultonte ndjeshëm më e ulët se e ardhura e pretenduar prej 1.400.000 lekë. Nuk provohet transaksioni as i pagesës së kësaj shume, si dhe gjatë hetimit nuk rezulton të jetë provuar as pagesa e detyrimeve tatimore mbi këtë të ardhur të pretenduar, e cila në çdo rast, referuar ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimet në funksion të tij, do të duhej të tatohej si e ardhur e përfituar nga vetë subjekti.

¹⁵ Referohu fq.15 tabelës përmbledhëse të rezultateve të hetimit, mbi pamjaftueshmërinë e konstatuar për çdo shlyerje të kësteve.

¹⁶ Referohu propësimeve të subjektit të rivlerësimit të datës 7.5.2024.

¹⁷ Referohu vlerësimeve të Komisionit fq. 13-19 të vendimit të arsyetuar

11.15.3 Lidhur me pretendimin e subjektit se ka përfitur gjithashtu të ardhura nga zyra e noterisë (të kumatës) me të njëjtat kushte kontraktuale si zyra e avokatisë së vëllait të subjektit, *Komisioneri Publik* vlerëson se këto pretendime mbetën në nivel deklarativ dhe nuk provohen me dokumentacion mbështetës.

11.15.4 Në përfundim, *Komisioneri Publik*, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga punësimi i subjektit si avokat, vetëm vlera e konfirmuar nga institucionet zyrtare në shumën 956.340 lekë, është shumë e cila plotëson standardin e vendosur nga neni D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, neni 32 pika 1, neni 49 pika 4 dhe neni 3 pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit.

11.15.5 Lidhur me burimin e deklaruar: *dhuratë nga vëllai ***.***., deklaruar në DV-Vetting në shumën 10.041 euro, depozituar në datën **.7.2003 pranë *** Bank*. Nga verifikimi i llogarive bankare rezulton se kjo shumë e ka origjinën nga një depozitim në llogarinë e subjektit në *cash* (pa u identifikuar depozituesi), në vlerën 19.000 euro më datë ** korrik 2003. Nga kjo shumë, në të njëjtën datë, vlera prej 10.000 euro është investuar në depozitë 3 mujore deri në datë ***.10.2003, kur është riinvestuar në depozitë 1 mujore, dhe kjo depozitë pas maturimit është rikthyer po në llogari të subjektit. Pjesa e mbetur prej 9.000 euro, ka qenë e depozituar në llogarinë e tij deri në momentin e tërheqjes totale (19.100 euro) në **.2.2004, pra pasi ishte paguar kësti i parë për apartamentin në rrugën “**** ****”, datë ** shtator 2003.

11.15.6 Bazuar në sa më sipër, *Komisioneri Publik* vlerëson se kjo shumë e deklaruar nga subjekti, nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë deri në datë **.9.2003 pasi rezulton tërhequr nga llogaria bankare në datë **.2.2004. Nuk rezulton që në *DV-2004*, subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar posedimin e kursimeve në *cash* apo tërheqjen *cash* nga llogaria bankare, e rrjedhimisht kjo shumë vlerësohet se nuk mund të ketë shërbyer as si burim as për pagimin e kësteve të tjera për apartamentin. Gjithashtu, edhe vetë subjekti gjatë hetimit administrativ ka pohuar se deklarimi si burim i kësaj pasurie i shumës prej 10.041 euro, dhuruar nga vëllai, ishte një gabim në interpretimin e lëvizjeve të llogarisë bankare.

11.15.7 Lidhur me burimin e deklaruar: *Hua në shumën 4.000 usd të dhënë cash nga ***.***. në Gusht 2003*, deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr.2 të Komisionit si burim për pagesën e këstit të parë, si pjesë e një huaje më të madhe prej 23.000 usd e marrë nga bashkëshortja e subjektit nga ***.***., sipas kontratës noteriale të datës **.9.2005, *Komisioneri Publik* konstaton se, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarimin mbi burimin e pagesës së këstit të parë të apartamentit. Kjo shumë deklarohet për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që në deklaratën para fillimit të detyrës, shuma prej 23.000 euro është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit si burim për një apartament tjetër (sikundër do të trajtohet në vijim, atë në rr. “**** ****”). Në këto rrethana, kjo shumë nuk duhet të merret në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme dhe në analizën për blerjen e apartamentit ndodhur në rrugën “**** ****”.

11.15.8 Duket se deklaratimet e subjektit si më sipër, janë bërë në funksion të përmbyesjes së barrës së provës, nisur dhe nga fakti se shumatat e deklaruara nuk përputhen në vlerë dhe në

monedhë; si dhe në kontratën e huasë të vitit 2005 lidhur midis ***.***. dhe bashkëshortes së subjektit nuk përmendet kjo shumë (4.000 usd) apo mënyra e shlyerjes së saj¹⁸.

11.15.9 Lidhur me burimin e deklaruar: Të ardhura nga emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale, Komisioneri Publik, bazuar dhe në standardet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, vlerëson se të ardhurat nga emigracioni, të padeklaruara dhe në D.-Vetting, në mungesë të dokumentacionit provues dhe për të cilat nuk mund të provohet burimi i ligjshëm, nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të analizës financiare. Edhe sa i përket të ardhurave të pretenduara nga firmat piramidale, deklaruar me burim nga të ardhurat nga emigracioni, përveçse mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i tyre, duket se janë një burim i shtuar i deklaruar vetëm në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, me qëllim përmbysjen e barrës së provës¹⁹.

*11.15.10 Lidhur me burimet për pagesën e këstit të dytë prej 10.000 usd në datë **.9.2005; këstit të tretë prej 1.270.000 lekë në datë **.10.2005 dhe pagesat cash për mobilimin prej 239.000 lekë²⁰, në analizë të burimit: dhurime nga vëllai ***.***, nga verifikimi i akteve në dosje rezulton se në llogaritë bankare të subjektit janë kryer 2 transferta ndërkombëtare në mbërritje me urdhërues ***.***. (vëllai), përkatësisht në datën **.4.2004 në shumën 7.000 euro me përshkrimin “Int transfer-credit from ***.***”, tërhequr nga subjekti datë **.4.2004, si dhe transferta prej 5.760,40 euro në datë **.9.2004, tërhequr nga subjekti datë **.9.2004.*

11.15.11 Komisioneri Publik vlerëson se këto shuma nuk mund të konsiderohen si burime për shlyerjen e këstit të dytë dhe mbulimin e shpenzimeve shtesë/mobilim gjatë vitit 2005, për sa kohë që në DV-2004, subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto shuma si kursime në cash në fund të vitit. Këto shuma nuk rezultojnë të jenë deklaruar si burim për apartamentin në asnjë prej deklaratave në vitet pasuese, si dhe nuk rezultojnë të jenë deklaruar dhe provuar me akte justifikuese nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të deklaratimit të burimeve të pasurive së bashku me deklaratën vetting.

*11.15.12 Lidhur me arsyetimin e Komisionit se [...] (i) subjekti provoi disponimin real të kësaj gjendjeje pjesërisht nga tërheqja e transfertave të kryera nga shtetasi ***.*** në shumën 12.760 euro gjatë vitit 2004 dhe pjesërisht (shuma 2.818.195 lekë) nga tërheqja e gjendjeve bankare dhe depozitave bankare të tij pranë *** Bank në vitin 2004; (ii) subjekti arriti të provojë se kishte pasaktësi në deklaratimin e tij në deklaratimin si OPGJ në vitin 2004, por ai nuk e dispononte si gjendje cash vlerën e tyre, e cila i ishte dhënë hua shtetases ***.*** dhe shtetasit ***.*** për investime të tyre, të cilat u provuan me dokumentacion; (iii) subjekti, edhe pse jo saktësisht, ka deklaruar në deklaratën Vetting vlerën 10,041 euro, e cila u provua nga hetimi i Komisionit se ishte mbajtur si depozitë kursimi dhe ishte tërhequr në vitin 2004, pra e ka deklaruar këtë kursim/depozitë; (iv) periudha e kryerjes së këtyre veprimeve rezulton të jetë përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit²¹[...],*

¹⁸ Për më tepër, subjekti, burimin nga të ardhurat nga shtetasi ***.***, i deklaron në deklaratën vetting (në fq. 10) si pjesë e huasë nga ***.***. për blerjen e apartamentit me adresë në rrugën “***”.

¹⁹ Në variantin më garantist, të ardhurat nga firmat piramidale të padeklaruara më parë nga subjekti, edhe nëse merren në konsideratë, do të jenë në shumën 143.113 lekë në vend të 873.113 lekë marrë nga Komisioni.

²⁰ Në analizën e tij, komisioni i ka llogaritur shpenzimet për mobilim të kryera përpara se subjekti të fillonte të jetonte në të.

²¹ Prgrf. 25.35 i vendimit të arsyetuar.

Komisioneri Publik vlerëson se, për sa kohë kursimet në cash nuk janë deklaruar si të tilla në DV-2004, nuk mund të mbarten për të mbuluar shpenzimet apo investimet e kryera në vitet 2005 deri në 2009²². Këto pretendime të subjektit në mungesë të provave dokumentare, nuk arrijnë të kapërcejnë natyrën deklarative. Deklarata noteriale e depozituar nga subjekti në funksion të deklarimeve të tij dhe e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, merret me rezervë në këtë proces²³.

11.15.13 Nga verifikimi i akteve në dosje rezulton se Komisioni ka kryer analizën financiare deri në Korrik 2005²⁴, ndërkohë që pagesat e kësteve janë kryer në datat **.9.2005 dhe **.10.2005. Nga aktet në dosje rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur kursime në shumën 21.000 usd në llogarinë e saj në bankë, me burim nga depozitimi cash i bërë në ** Gusht 2005, të cilat nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, bazuar në deklarin se kjo shumë vjen nga shtetasi **.*.***. Në konsideratë të sa më sipër, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën janar 2005²⁵ - tetor 2005, nga analiza financiare e shtrirë deri në datën e pagesës së këstit të tretë dhe shpenzimeve shtesë/mobilimit, do të rezultonte mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën rreth - 4.1 milion lekë²⁶, për të mbuluar pagesat dhe shpenzimet/investimet të tjera.

11.15.14 Duke përfunduar për sa argumentuar më sipër, për pasurinë apartament ndodhur në rrugën “*** **” me sip. 72,20 m², *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjafueshmëri të burimeve financiare për pagesën e këstit të parë për të gjithë shumën në vlerën 9.040 usd; pamjafueshmëri të burimeve të ligjshme deri në datën e pagesës së këstit të dytë dhe mbulimin e shpenzimeve të mobilimit, (përlllogaritur në shumën 4.1 milion lekë). Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, duke ndryshuar deklarin nga dhurim në shumën 10.041 euro nga vëllai i tij **.*.***. (deklaruar në D.-Vett.) në hua nga **.*.***. në shumën prej 4.000 usd (deklaruar gjatë hetimit administrativ).

12. Apartament banimi në rrugën “*** **”

12.1 *Në Deklaratën e Interesave Publike para Fillimit të Detyrës të vitit 2009*, dorëzuar në **.12.2009, personi i lidhur me subjektin deklaroi: “*Apartament banimi me sip.103 m², dy*

²² Duket se Komisioni në analizën e kryer ka marrë në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme dhe shumat 3.349.749 lekë gjendje në llogaritë bankare gjatë vitit 2003 dhe tërhequr në 2004, si dhe balancën pozitive prej 4.858.629 lekë të vitit 2004.

²³ Deklaratë noteriale e datës **.5.2023 ku deklarohet se: Në lidhje me huanë e sipërmendur, subjekti ka vënë në dispozicion të hetimit deklaratën noteriale datë **.5.2023, nënshkruar nga **.*.***. dhe **.*.***. të cilët, ndër të tjera deklarojnë se: [...] në vitin 2005, mbesa jonë **.*.***. (vajza e motrës) kanë bërë ceremoni martesore me **.*.***. të cilët vazhdojnë të jenë të martuar dhe që nga ajo kohë jetojnë dhe banojnë në Angli. Në datë **.8.2005 ata janë martuar dhe më datë **.8.2005, meqenëse do largoheshin nga Shqipëria, disa të ardhura të krijuara nga puna në Mbretërinë e Bashkuar në masën 22.600 dollarë i kanë derdhur në llogarinë e **.*.***. (bashkëshortja e Afrimit). Sasia prej 22.600 euro, duke qënë se ne ishim në dijeni të kësaj shumë më datën **.10/2005, ju kemi marrë shumën prej 21.000 dollarë dhe në datën **.9.2005 shumën prej 1.600 dollarë të cilat i kemi përdorur për nevojat tona familjare deri nga vera e vitit 2009. Pas këtij momenti kjo shumë në vlerën 22.600 dollarë i'a kemi dhënë nipit tonë **.*.***. (kupati i **.*.***), pas këto ishin të ardhura të krijuara nga **.*.***. në Mbretërinë e Bashkuar [...].

²⁴ Tabela nr.4 në fq.17 të vendimit të Komisionit.

²⁵ Duke marrë në konsideratë se subjekti ka deklaruar interesat privatë në ILDKPKI në vitin 2004 në pozicionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

²⁶ Referohu tabelës në fq. 9 të Rekomandimit të ONM-së..

dhoma e një kuzhinë në rrugën “**** **”. Kontrata e sipërmarrjes nr. ***/*** rep/kol dt **/6.2008, notere ***/***. Vlera **61.800 euro**. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (i) Dhuratë nga babai 40.000 euro. Deklaratë noteriale nr. ***/*** rep/kol, dt. **/10.2009, notere ***/***.; (ii) Hua sipas kontratës nr. ***/*** rep/kol, dt. **/9.2005, vlera 23.000 usd marrë nga ***/***. (kupati).”

12.2 Në DV-2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “Shitja e apartamentit me sipërfaqe 89,95 m², me nr. */***+*-, në adresë rruga “**** **”, hyrja *, ap. **, Tiranë, sipas kontratës *** rep/*** kol, datë **/10.2016. Vlera 85.000 euro” (vlerë e cila deklarohet si në nga burimet e apartamentit në rrugën “**** **” që do të analizohet në vijim).

12.3 ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. ***/** prot. dt. **/3.2021, bashkëlidh kopje të kontratës së shitblerjes me nr. ***/***, dt. **/7.2012, për apartamentin me sip.89,95 m², në rr. “**** **”, me palë shitëse ***/***. dhe ***/***., dhe palë blerëse Afrim dhe *** **, përkundrejt çmimit prej 6.341.775 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale nëpërmjet bankës dhe cash sipas kontratës së sipërmarrjes.

12.4 Përsa i përket ndryshimit në çmimin e blerjes midis kontratës së sipërmarrjes me vlerë 61.800 euro (rreth 7.612.679 lekë) dhe kontratës së shitjes prej 6.341.775 lekë, subjekti gjatë hetimit administrativ²⁷, ka deklaruar se [...]Nga përfaqësuesi i shoqërisë jam sqaruar se ...ka pranuar kërkesën që punimet e brendshme të kryheshin nga znj. *** ** dhe më pas këto punime janë vlerësuar rreth 10.000 euro, vlerë e cila është paguar nga znj. *** ** në arkën e shoqërisë. Më pas kjo vlerë është zbritur nga vlera totale në kontratën e sipërmarrjes. Vlera e ndryshuar është reflektuar më pas në kontratën e shitjes duke vendosur vlerën e shitjes 6.341.775 lekë. Pra, nga vlera totale është zbritur shuma 10.000 euro²⁸[...], duke përcjellë dhe kopje të situacion punimesh me objekt: “Punime shitesë dhe mobilim apartamenti me vlerë totale 2.480.940 lekë dhe mandat pagesë dt. **/10.2009 me vlerë totale 18.000 euro arkëtuar nga znj. *** **” me përshkrim “parapagim për punime shitesë dhe mobilim apartamenti nr. * *, në objektin me leje ndërtimi nr.*** dt. **/6.2006”.

12.5 Në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së këtij apartamenti, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të D-Vetting, subjekti ka deklaruar [...]Lidhur me apartamentin e shitur në vlerën 85.000 euro, sqaroj se është blerë në vlerën 61.800 euro, ku në datë **/6.2008 janë paguar 34.000 euro, si burim nga *** ** (babai i bashkëshortes) dhuratë për *** ** (bashkëshortja), sipas aktit noterial nr. *** rep/*** kol, datë **/10.2009. Burimi i shumës së dhuruar është nga puna e tij në Greqi, që në vitin 1999, vërtetuar kjo nga vizat ndër vite, me leje pune me nr.***, datë **/8.2003, si dhe dokumentet e dorëzuara në organet tatimore në Greqi, që provojnë të ardhurat mujore[...].

12.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti ka përcjellë kopje të kontratës së shitjes të pasurisë apartament banimi me rezervë nr. *** rep, nr. *** kol, datë **/6.2008, lidhur

²⁷ Pyetësori nr.2 i Komisionit.

²⁸ Nga aktet në dosje ka rezultuar shkresë dt.**/10.2009, nga shoqëria “****” sh.p.k. sipas së cilës [...]Për apartamentin e porositur nga *** **, është detyrim i kompanisë “****” shpk që të dorëzojë të përfunduar apartamentin e porositur prej *** ** për llogari të *** **, në cilësinë e pronarit të truallit, detyrim që rrjedh në zbatim të kontratës nr. ***/*** dt. **/4.2007 të nënshkruar nga administratori dhe ortak i vetëm i shoqërisë dhe nga *** ** në cilësinë e ofrimit të truallit për ndërtim [...].

mes *** *** dhe shtetasit ***. ***. për shitjen me rezervë të apartamentit të banimit *** , në total me një sipërfaqe 103 m²,²⁹ ku citohet se kësti i parë prej 34.000 euro, është paguar në prezencë të noteres, ndërsa kësti i dytë dhe i fundit prej 27.800 euro do të likuidohet nëpërmjet kredisë bankare që pala blerëse do të marrë për këtë qëllim.

12.7 Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të kryer çmimin e blerjes së apartamentit prej 61.800 euro sipas kontratës së porosisë të datës **.6.2008, duke i shtuar vlerën prej 18.000 euro për punimet shtesë sipas mandat pagesës dt. **.10.2009, një vlerë total 79.800 euro³⁰.

12.8 Lidhur me burimin e deklaruar: *“Dhuratë nga babai i bashkëshortes 40.000 euro me deklaratë noteriale nr. ***/*** dt. **.10.2009”* dhe mospërputhjen me deklarinim në *D-Vetting*, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti ka deklaruar [...] *Siç është deklaruar nga ana ime, dhurata nga shtetasi *** *** është në vlerën 40.000 euro, kjo e konfirmuar me deklaratën noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. **.10.2009, notere ***. ***.. Nga vlera totale e dhuruar prej 40.000 Euro është përdor si burim vlera 34.000 euro në datë **.06.2008 për pagesën e përshkruar në kontratën e shitjes me rezervë nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.06.2008 e lidhur nga znj. *** *** me z. ***. ***.. Ndërsa pjesa tjetër prej 6.000 Euro është përdor më vonë, po për të njëjtën banesë për mbylljen e të gjithë detyrimeve të këtij apartamenti[...].*

12.9 Në analizë të burimeve të ligjshme të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. ***. *** , Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2003-shkurt 2008, nga ku, ka konstatuar se: [...] *Duket se, z. ***. ***.... rezulton se ka pamundësi në vlerën 8.499 euro ose rreth 1.046.938 lekë, për të dhënë me të ardhura të ligjshme vlerën 40.000 euro, bashkëshortes së subjektit[...].*

12.10 Lidhur me burimin tjetër: *“Hua sipas kontratës nr. ***/*** rep/kol dt. **.9.2005, vlera 23.000 usd marrë nga *** *** (kunati)”*. Nga hetimi ka rezultuar se në DV-2010, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Hua në shumën 23.000 usd, për blerje banese, sipas kontratës nr. ***/*** datë **.09.2005. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 11.500 usd. E shlyer totalisht.”* Në të njëjtën deklaratë ajo ka deklaruar: *“Nga të ardhurat e pagës së mësipërme janë kursyer një shumë prej 500.000 lekë, ndërsa një shumë prej 200.000 lekë dhe depozita e bashkëshortit prej 7.000 euro kanë shërbyer për shlyerjen e huasë së mbetur në shumën 11.500 dollarë”*.

12.11 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se [...] *në fakt kjo vlerë ka burim të ardhurat në shtetin anglez të shtetasit ***. ***. (bashkëjetuesi i mbesës). Ata kanë rënë dakort që huaja të formalizohet me kontratë huaje nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.09.2005 me shtetasin ***. ***.. Vlera e huasë është marrë në cash 4.000 usd në gusht të vitit 2003 dhe vlera 15.296 euro në muajin tetor 2005 nëpërmjet *** Bank³¹[...].*

12.12 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit pranë *** bank, rezulton se në datë **.10.2005 ka mbërritur transfertat ndërkombëtare me vlerë 15.296,4 euro, për të cilën subjektit

²⁹ Me sipërfaqe 91 m², me sipërfaqe shkalle 8,9 m² dhe me sipërfaqe të ambienteve të shërbimit 3,1 m²,

³⁰ Pasi nuk u provua gjatë hetimit se diferenca e çmimit vjen nga kryerja e punimeve shtesë nga bashkëshortja e subjektit dhe se shoqëria ka shlyer shtetasin *** *** për diferencën e vlerës prej 10.000 euro

³¹ Trajtimi i shumës 4.000 usd cash është bërë me pasurinë e parë, apartament në rr. “**** ****”, pasi kjo shumë është deklaruar si burim për pagesën e kësaj pasurie.

ka përcjellë shkresë përgjigje nga *** Bank sh.a. dhe ka deklaruar ndër të tjera se [...]Duke j'u referuar të dhënave të gjendura në sistemin e bankës, si dhe lëvizjes së llogarisë bankare me nr. *** rezultoi se në datën **.10.2005 në këtë llogari është kredituar një transfertë ndërkombëtare në emërin tim, me urdhërues Mr. ***.***, në vlerën 15.296,4 Euro[...].

12.13 Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me: [...] pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “*** ***”, Tiranë, rezultuar nga analiza financiare në shumën – 4.065.392 lekë dhe mbi diferencën në shumën totale të burimeve të deklaruara prej bashkëshortes, në vlerën 55.296,58 euro, me vlerën e çmimit të blerjes së apartamentit, në shumën 61.800 euro. Gjithashtu, i kërkoi shpjegime për arsyen e marrjes së huas prej 23.000 usd nga bashkëshortja dhe subjekti në vitin 2005, ku nga hetimi rezultoi se kontrata e shitjes me rezervë për apartamentin e ndodhur në rr. “*** ***” është lidhur në vitin 2008 dhe po në të njëjtin vit ka nisur edhe shlyerja e kësaj huaje. Subjekti duhet të japë shpjegime edhe për vlerën e transferuar nga shtetasi ***.***, në llogarinë e tij mbi qëllimin e transfertës dhe mënyrën e përdorimit të saj [...].

12.14 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera ka pretenduar përshirjen e shumës 49.000 euro në analizën financiare si burim për krijimin e kësaj pasurie dhe mobilimit të saj, si dhurim nga z. ***.***. (40.000 euro + 9.000 euro), pasi sikundër ka rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit, në llogarinë e subjektit pranë *** Bank datë **.3.2009 ka rezultuar se është kredituar dhe transferata në shumën 9.000 euro nga shtetasi ***.***., shumë e cila pretendohet se është dhuruar nga i ati i bashkëshortes ***.***, transferuar nga llogaria bankare e shtetasit ***.***.

12.15 Pas vlerësimit të prapësimeve dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, Komisioni, lidhur me këtë pasuri ka vlerësuar se:

12.15.1 [...]Lidhur me burimet e huadhënësit, shtetasit ***.***., Komisioni çmoi se analiza financiare për blerjen e apartamentit në rr. “*** ***” prej bashkëshortes së tij, duhet të rishikohet duke u përfshirë edhe të ardhurat e përfituara prej tij nga pensioni dhe të ardhura të tjera. I ati i bashkëshortes së subjektit ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme shumën e dhuruar prej 40.000 euro. Ndërsa në lidhje me vlerën e transfertës në llogarinë e subjektit pranë *** Bank, në datën **.3.2009, nga dërguesi ***.***., Komisioni vlerësoi se për këtë vlerë është arritur elementi i provueshmërisë, por Komisioni çmon se nuk do të përfshihet si burim për krijimin e apartamentit, pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë as në deklaratën Vetting dhe as në deklaratat periodike vjetore[...].

12.15.2 Në përfundim, Komisioni, pasi ka vlerësuar se çmimi i blerjes së këtij apartamenti në analizën financiare do të konsiderohet në vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes prej 61.800 euro³², vlerësoi se subjekti është në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në rr. “*** ***” me të ardhura të ligjshme në shumën - 6.504 euro ose rreth - 892.099 lekë³³.

³² Komisioni ka arsyetuar se: 26.19 Komisioni vlerësoi se duke u mbështetur në praktikën e tij analiza financiare duhet përditësuar, duke përfshirë si çmim blerjeje për apartamentin vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, me të cilën është bërë edhe regjistrimi i apartamentit pranë zyrave të kadastrës. Gjithashtu, subjekti arriti të provojë me dokumentacion ligjor, në të cilin përfshihet deklarimi i të gjitha palëve, se vlera totale e këtij transaksioni (blerja e apartamentit) është në shumën 61.800 euro dhe jo më shumë.

³³ Referohu prgrf. nr 26.20.12 e në vijim në vendimin e arsyetuar.

12.16 *Komisioneri Publik*, për sa më sipër trajtuar, lidhur me pasurinë apartament banimi ndodhur në Tiranë me adresë rruga “**** ****”, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, për sa më poshtë trajtuar:

12.16.1 Fillimisht përsa i përket *vlerës së paguar për pasurinë*, konsideruar nga Komisioni në analizë në vlerën 61.800 euro, vlerësohet se ky konkluzion i Komisionit gjendet i paqartë dhe i pambështetur në aktet në dosje, për sa kohë që, nga hetimi administrativ dhe nga aktet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se për këtë pasuri është paguar të paktën shuma prej 61.800 euro sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. ****/**** të datës **.6.2008, plus shuma prej 18.000 euro sipas preventivit dhe mandat-arkëtimit të datës **.10.2009. Për më tepër, mbeti e paprovuar se diferenca në çmim ka ardhur si rezultat i punimeve shtesë të kryera me kërkesë të bashkëshortes së subjektit. Gjithashtu, çmimi prej 61.800 euro rezulton i deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në *Deklaratën e Interesave Private para Fillimit të Detyrës të vitit 2009 dhe atë Vetting*, pa detajuar kostot dhe pa përmendur diferencën prej 8.000 euro të pretenduar për mobilimin.

12.16.2 Në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, vlera prej 61.800 euro së bashku me shumën prej 18.000 euro, duhet të konsiderohen si kosto totale e apartamentit në analizën e kryer për periudhën deri në datën e dorëzimit të deklaratës datë **.12.2009.

12.16.3 *Lidhur me mundësinë e dhuruesit, shtetasit ****.***., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar të dhuruar prej 40.000 euro*, Komisioneri Publik në vlerësim të pretendimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti (*vetëm pas kalimit të barrës së provës*), vlerëson se për efekt të këtij procesi, duhet të merren në konsideratë të ardhurat nga pensioni i ****.***. vetëm për periudhën 2003-Mars 2008³⁴, pasi të ardhurat e tjera përpara kësaj periudhe janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetësës. Megjithatë, këto të ardhura nuk përmbysin balancën negative të konstatuar nga Komisioni për personin tjetër të lidhur³⁵ ****.***..

12.16.4 *Lidhur me mundësinë e huadhënësit, shtetasit ****.***. për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 23.000 usd*, Komisioneri Publik në vlerësim të pretendimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti, konstaton deklarime kontradiktore, pasi sikundër ka rezultuar nga hetimi administrativ në llogarinë bankare të subjektit pranë **** Bank, provohet vetëm transferata e shumës 15.296 euro në datë **.10.2005, me urdhërues ****.***.. Ndërkohë kontrata e huasë, e datës **.9.2005, nënshkruar ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit ****.***., referon se bashkëshortja e subjektit ka marrë shumën e dhënë hua prej 23.000 usd, ndërsa në Deklaratën Noteriale të datës **.8.2019, huadhënësi ****.***. deklaron se ka transferuar shumën e huasë në datë **.5.2005.

³⁴ Të llogaritura në masën rreth 585.512 lekë (ose 4.778 euro).

³⁵ Shuma tjetër prej 9.000 euro transferuar (5.3.2009) në llogarinë e subjektit pranë **** Bank nga ****.***. (bashkëshorti i motrës së ****.***.) nga Greqia dhe pretenduar nga subjekti në parashtrimet përfundimtare si dhuratë nga ****.***. (babai i bashkëshortes) dhe e përdorur për financimin e punimeve shtesë/mobilimin e apartamentit në vitin 2009³⁵, edhe pse provohet me transaksionin bankar, në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, ashtu sikurse konstatuar dhe nga Komisioni, nuk mund të jetë pjesë e burimeve të krijimit të pasurisë, për sa kohë që nuk rezulton e deklaruar si e tillë nga subjekti në asnjë nga deklaratat periodike vjetore, apo në atë vetting dhe as në deklaratën noteriale të huasë nr. ****/**** të datës **.10.2009 të shtetasit ****.***.

12.16.5 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka depozituar në *cash* në llogarinë e saj në datë **/8.2005 shumën 22.600 usd (tërhequr më pas në dt **/9.2005 dhe **/10.2005), shumë e cila gjithashtu deklarohet nga subjekti se janë të ardhura të shtetasit ***/***, lënë në ruajtje bashkëshortes së subjektit. Kjo shumë, deklarohet se i është dhënë vëllait tjetër, ***/***, për nevojat familjare dhe në vitin 2010 pretendohet se i është kthyer shtetasit ***/***, nga ***/***, dhe deklarohet nga subjekti si pjesë e huasë përdorur për apartamentin në rrugën “**** **”, pasuri që do të trajtohet në vijim.

12.16.6 Deklarimet si më sipër të subjektit, mbeten në nivel deklarativ dhe jo bindëse, pasi duket se subjekti përpiqet të justifikojë krijimin e pasurive të tij me të ardhurat e ***/***, ndërkohë që nga aktet rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur në dispozicion në llogarinë e saj bankare shumën prej 22.600 usd po të shtetasit ***/***, në momentin e marrjes së huasë. Në këto rrethana, duket se shuma prej 22.600 usd ka si burim fonde të vetë subjektit të rivlerësimit³⁶.

12.16.7 Lidhur me shlyerjen e huas prej 23.000 usd, në Deklarimin Para Fillimit të Detyrës të vitit 2009, deklarohet se detyrimi i mbetur ndaj ***/***, është në shumën 11.500 usd, ndërsa në DV-2010 deklarohet “pakësuar depozita në shumën 7.000 euro, në llogarinë rrjedhëse pranë ***/Bank...duke e përdorur për pagesën e huasë së bashkëshortes”.

12.16.8 Nga verifikimi i llogarisë së subjektit pranë **/ konstatohet se kjo depozitë vjen nga kreditimi i shumës 9.962 euro në maj 2009, nga ***/**/ me përshkrimin “Dhënie huaje”, e cila nuk rezulton e deklaruar si detyrim në DV-2009. Kjo shumë rezulton se investohet nga subjekti në depozitë deri në vitin 2010. Komisioneri Publik vlerëson se, meqenëse gjatë hetimit administrativ në Komision nuk u provuan burimet e ligjshme të ***/***, sikundër do të analizohet dhe në vijim, për të dhënë këtë hua, rrjedhimisht tërheqja e depozitës në vitin 2010, për efekt të këtij procesi nuk mund të konsiderohet si burim në këtë vit për shlyerjen e huasë të marrë nga ***/**/.

12.16.9 Edhe në këtë rast, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se edhe kjo shumë ka si burim të ardhurat e shtetasit ***/**/ dhe nuk është deklaruar në deklaratën e parë, pasi shlyerja është bërë përpara se të dorëzohej deklarata para fillimit të detyrës të 2009³⁷.

12.16.10 Deklarimet e subjektit edhe lidhur me këto transaksione mbeten në nivel deklarativ³⁸ dhe nuk duket se kjo shumë, ka si burim të ardhurat e ***/**/., për sa kohë që transfertat ka ardhur nga ***/**/.

12.17 Për gjithë sa trajtuar, në lidhje me pasurinë, apartament në rr. “**** **”, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se nga analiza financiare, rezulton pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të e të tjerë të lidhur me të, për të mbuluar shpenzimet, kursimet dhe investimet në pasuri të

³⁶ Kjo shumë e tërhequr nga llogaria bankare në vitin 2005 nuk rezulton të jetë deklaruar/qartësuar nga subjekti si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër.

³⁷ Nuk rezulton që Komisioni këtë shumë ta ketë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, as përfitimi dhe as shlyerja e kësaj huaje, meqenëse sipas subjektit kjo shumë ishte shlyer brenda vitit.

³⁸ Komisioni gjithashtu ka marrë në konsideratë edhe pretendimet e subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit në vitin 2009, pretendimet mbi mbulimin e kostove të udhëtimit të bashkëshortes në datat ***/**/ shkurt 2009, të cilat vlerësojmë se nuk provohen me dokumenta justifikues. Përsa i përket udhëtimit të dates ***/**/ 8.2009, bazuar në aktet e paraqitura nga subjekti, vlerësojmë se këto kosto duhen përfshirë në analizën financiare bazuar në jurisprudencën e Kolegjit vendim (JR) nr. 11/2019.

luajtshme e të paluajtshme³⁹. Deklarimet e subjektit vlerësohen kontradiktore edhe lidhur me dhurimin e shumës 9.000 euro nga babai i bashkëshortes, shumë që rezultoi e transferuar nga ***.***., e padeklaruar më parë nga subjekti dhe për të cilën subjekti, vetëm në përfundim të hetimit administrativ, pretendoi se vinte nga të ardhurat e babait të bashkëshortes⁴⁰. Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të aneksit të Kushtetutës.

13. Pasuria Garazh me adresë në rrugën “*** **”

13.1 Në deklaratën para fillimit të detyrës, të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: “Garazh, me dy vende parkimi nr. ** dhe nr. **, me sipërfaqe 35 m² në Rrugën “*** **”, pallat i ndërtuar nga shoqëria “***”, kontrata nr. *** Rep, Dhe *** Kol datë **.11.2009, vlera 14 000 euro, pjesa takuese 100%”. ASHK nuk konfirmon pasurinë në emër të subjektit dhe/ose bashkëshortes me këto të dhëna.

13.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të Komisionit, subjekti ka deklaruar se: “Me kontratën *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë **.9.2019 është zgjidhur në mënyrë vullnetare Kontrata e Sipërmarrjes me numër ** Rep dhe Nr *** Kol datë **.11.2009, për dy vende parkimi në vlerën 14.000 euro duke i rikthyer palët në gjendjen e mëparshme. Kjo vlerë është kthyer nëpërmjet bankës në llogarinë time në *** Bank, vlera 13.950 Euro dhe vlera 50 euro Cash.”

13.3 Në lidhje me arsyen e revokimit të kontratës së sipërmarrjes datë **.11.2009 dhe kthimi i së njëjtës vlerë 14.000 euro, sa ka qenë edhe vlera e porosisë për pasurinë, edhe pasi e ka përdorur për rreth 10 vjet, subjekti ka dhënë përgjigje pyetësorit numër 2 të Komisionit⁴¹.

13.4 *** bank⁴² konfirmon se në dt.**.09.2019 subjektit i ka kaluar shuma 13.948,8 euro me përshkrim “Kalim sipas akt marrveshjes nr *** rep dhe nr *** kol dt **.09.19 per zgjidhjen e kontratës nr. *** rep dhe nr. *** kol dt. **.11.09” nga llogaria e noteres ***.***..

³⁹ Referuar dhe rekomandimit të ONM-së, pamjaftueshmëria financiare e akumuluar për periudhën 2006-2009 do të rezultonte në vlerën prej – 6.632.151 lekë, marrë në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive vetëm shumën 15.296 euro, si dhe mundësisë financiare të huadhënësit ***.*** për të dhuruar shumën deri në 36.280 euro, sipas mundësisë së kursimit të analizuar më sipër.

⁴⁰ Edhe në një vlerësim tejet garantist të situatës së subjektit, megjithëse deklarimet e tij duken të paqarta dhe kontradiktore lidhur me këtë pasuri, ashtu sikundër konstatuar dhe nga Komisioni, dhe në variantin e përllogaritjes së shpenzimeve për këtë pasuri sipas pretendimeve të subjektit, përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të tij për krijimin e kësaj pasurie.

⁴¹ “Në lidhje me këtë pyetje unë i jam drejtuar me një kërkesë për informacion shoqërisë “****” sh.p.k. Përfaqësuesi i kësaj shoqërie më është përgjigjur, duke arsyetuar se: Revokimi i kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***/rep/kol, datë **.11.2009, për një Garazh, në Rrugën “*** **”, Pallati ***, me dy vendparkime (nr. **, **), me sipërfaqe 35m², në katin (-2), shkalla **, ka ndodhur sipas kërkesës tuaj. Zona ku ndodhen këto vendparkime, pavarësisht rritjes së vlerës së tregut të pasurive të paluajtshme nuk kishte kërkesa për garazhe. Zona është e varfër dhe qytetarët blejnë vetëm banesë, jo parkime. Aktualisht shumica e parkimeve janë në pronësi të shoqërisë. Duke qenë se garazhi im, ndodhej në katin -2 dhe shoqërisë i shërbente për ta shfrytëzuar të gjithë së bashku, në marrëshje u dakortësuam që të të më kthente të njëjtën vlerë. Theksoj, se unë garazhin e kam përdorur nga muaji Korrik i vitit 2010 deri në muajin Janar 2017, kohë kur unë kam lëvizur nga ajo zonë dhe kam ardhur të banoj në rrugën “**** **”. Pas largimit nga ajo zonë, kisha vënë në shitje apartamentin dhe garazhin. Për apartamentin kishte kërkesa dhe është shitur, ndërsa për garazhin nuk kishte kërkesa. Duke qenë se nga Janari i vitit 2017, nuk munda ta shes, kam biseduar me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k, i cili më ofroi mundësinë e revokimit të kontratës së sipërmarrjes, duke më kthyer vlerën që i kisha dhënë dhe ai të merrte garazhin. Kjo zgjidhje na shërbente të dy palëve, pasi unë shisja garazhin ndërsa, ai në katin – 2, kishte shumë garazhe të pashitura dhe i përdorte të gjithë me qira ditore dhe mujore.

⁴² Shkresa *** bank sha nr. ***/** prot dt. **.03.2021, nr. **/** prot. dt. **.11.2022 dhe shkresa ***/** prot dt. **.09.2023.

13.5 Lidhur me burimin e ligjshëm për blerjen e këtyre pasurive në vitin 2009, nga verifikimi i akteve ka rezultuar se subjekti ka deklaruar si burim, *të ardhura nga puna ndër vite së bashku me bashkëshorten*.

13.6 Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se [...] *duket se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi në krijimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme në vlerën totale të saj prej -14.000 euro ose rreth – 1.920.380 lekë* [...], rezultat për të cilin bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i ka kaluar barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

13.7 Pas vlerësimit të shpjegimeve dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti në përgjigje të barrës së provës⁴³, Komisioni ka vlerësuar se në analizën financiare përfundimtare, rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi të kryerjes së pagesës së blerjes së garazheve me të ardhura të ligjshme në shumën (-1.677.880 lekë ose rreth -12.232 euro)⁴⁴.

13.8 *Komisioneri Publik*, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, si dhe vetë konkluzionet e Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me këto pasuri, referuar neni 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe rezulton me një mungesë të burimeve financiare të ligjshme në një diferencë të konsiderueshme, parë kjo në raport dhe me gjetjet e tjera të kontrollit të pasurisë⁴⁵. Për sa trajtuar dhe më sipër, mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e vitit 2009, vlerësohet se pamjaftueshmëria financiare për pasurinë “garazh” ndodhur në rrugën “**** ****”, shkon përtej asaj të vlerësuar nga Komisioni, në vlerën e plotë të blerjes së tyre.

14. Pasuria Apartament me sip. 96,5 m² me adresë në rrugën “** ****”**

14.1 *Në D.- Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sip. 96,5 m² me adresë në rr. “**** ****”, H.*, ap.**, rregjistruar në z.k. ****, me nr. */****+*-**, vol.**, faqe *, kontratë porosie nr. ***/*** datë *.9.2015 dhe kontratë shitje nr. ***/*** datë **.10.2016. Paguar me këste: datë *.9.2015 – 40.000 euro, datë *.3.2019 – 39.952 euro, datë **.10.2016 dhe **.10.2016 – 22.840 euro. Burim krijimi: (i) llogari kursimi në emër të bashkëshortes pranë *** Bank krijuar me të ardhura ndër vite; (ii) hua nga ***. *** akti noterial ***/*** datë **.9.2016 (e shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); (iii) kursime ndër vite të deklaruara para datës **.12.2014; (iv) shitja e apartamentit me sip. 89,95 m² me nr. */****+*-**, në adresë Rruga “**** ****”, H.*, ap.**, Tiranë, sipas kontratës nr. ***/*** datë **.10.2016 me vlerë 85.000 euro. Vlera: 12.720.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

14.1.1 Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar: Shpenzime për mobilimin e apartamentit me sip. 96,5 m², me adresë në Rrugën “**** ****”, me burim: Hua nga *** ****, akti noterial nr. ***/***, datë **.9.2016 (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë), kursime ndër vite deklaruar para datës **.12.2014 dhe nga shitja e apartamentit në vlerën 85.000 euro. Vlera: 11.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

⁴³ Referohu gjerësisht prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara.

⁴⁴ Prgr. 27.8 i vendimit të arsyetuar.

⁴⁵ Referohu fq. 18 të rekomandimit të ONM-së.

14.2 Në DV-2015, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, tipi * objekti **, kati i *** me sip. 105,5 m² ...me adresë Rruga “**** ****”. Kontratë porosie nr. ***/*** datë *.9.2015 me shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera: 92.480 euro. Në çastin e lidhjes së kontratës paguar 40.000 euro. Burimi: (i) 2.682.923 lekë llogari kursimi në emër të *** ***; (ii) 5.000 dollarë hua nga *** ***; (iii) 1.010.000 lekë + 5.000 euro pakësuar cash, në banesë para datës **.12.2014; (iv) 994,25 dollarë tërhequr më datë **.2.2015 nga llogaria pranë *** A.Shehu; (v) 1.600 usd cash të ardhura Kroaci; (vi) teprica kursime të vitit 2015 të konvertuara 1.622 euro.

14.3 Në DV - 2016 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament, me sipërfaqe 96,50 m², me adresë në Rrugën “**** ****” hyrja *, Apartamenti **, rregjistruar në ZK ***, me numër */***+*_*_**, v1 **, faqe *, Kontratë Shitje nr.*** Rep dhe Nr. *** Kol datë **.10.2016⁴⁶. Vlera: 12.720.000 lekë. Burimi: (i) llogari kursimi në emër të *** ***; (ii) Hua nga *** *** 1.010.000 lekë akti noterial nr.*** rep. dhe nr *** kol. datë **.9.2016 (e shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); (iii) kursime ndër vite të deklaruara para datës **.12.2014; (iv) Shitja e apartamentit me sipërfaqe 89,95 m² me numër **/***+*_*_**, në adresë rruga “**** ****” hyrja *, ap. **, sipas kontratës nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë **.10.2016 në vlerën 85.000 euro.

14.3.1 Në të njëjtën deklaratë subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi në vlerën 11.000 euro me burim: (i) Hua nga **. ***, akti noterial nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.9.2016 (e shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); (ii) kursime ndër vite të deklaruara para datës **.12.2014 nga unë dhe bashkëshortja; si dhe (iii) nga shitja e apartamentit në vlerën 85.000 euro.

14.4 ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. ***/** prot. dt. **.04.2021 dhe shkresën nr. ***/** prot. dt. **.11.2023, konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë në bashkëpronësi pasurinë apartament me sip. 96,5m² regjistruar në zonën kadastrale ***, me nr. */***+*_*_**, volumi **, faqe *, të ndodhur në Rrugën “**** ****”, regjistruar në dt. **.10.2016, fituar nga kontratë shitje nr. ***/*** dt. **.10.2016 me shumë të paguar prej 12.270.000 lekë⁴⁷.

14.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, lidhur me pagesat e kryera për këtë apartament, subjekti ka deklaruar [...]Siç kam deklaruar, pagesa e kështit të parë për apartamentin me sipërfaqe 96,5 m² në Rrugën “**** ****”, hyrja *, Ap. ** Tiranë është kryer më datë **.09.2015 në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k., kundrejt mandatit përkatës të datës **.09.2015. Ndërsa kështet e tjera janë paguar nëpërmjet bankës. Në total vlera e paguar është 92.840 euro[...].

14.6 Lidhur me mospërputhjen e çmimit të pasurisë, pasi vlera e pagesave të përshkruara prej subjektit rezulton në shumën 102.792 euro, ndërsa në deklaratën vetting vlera e pasurisë

⁴⁶ Paguar më këste, datë *.9.2015, vlera 40.000 euro; datë *.3.2016 – vlera 39.952 Euro, datë **.10.2016 dhe **.10.2016, vlera 22.840 euro.

⁴⁷ Bashkëlidhur përgjigjes, përcillet kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep/*** kol, dt. **.10.2016 lidhur midis palës shitëse shoqëria “****” shpk dhe palë blerëse Afrim dhe *** *** me çmim shitje, likuiduar me këste jashtë zyrës noteriale, sipas kontratës së porosisë nr.*** rep/*** kol, dt. **.09.2015 në vlerën 92.840 euro ose ekuivalenti prej 12.720.000 lekë; si dhe kontratë porosie nr. *** rep/*** kol., datë **.9.2015, e cila konfirmon se bashkëshortja znj. *** *** ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k apartamentin me sip. të përgjithshme 105,5 m², nga e cila 96,5 m² sip. e brendshme është e hipotekueshme dhe sipërfaqe funksionale/përbashkët 9 m². Çmimi total i apartamentit është 92.840 m².

është deklaruar në shumën 12.720.000 lekë ose rreth 92,840 euro, subjekti e ka konsideruar atë si një gabim material në deklaram⁴⁸.

14.7 Komisioni ka analizuar secilin nga burimet e deklaruara nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie, analizë nga e cila ka rezultuar si më poshtë vijon:

14.8 Lidhur me burimin: *Hua nga ***. ***, në DV-2015 subjekti ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare: “5.000 usd, marrë hua nga shtetasi ***. ***, në muajin shtator 2015 për blerjen e banesës së porositur, nr. *** rep dhe *** kol, dt. **.09.2015, me shoqërinë “***” shpk.”*

14.9 Në DV-2016 subjekti deklaroi: *“Hua nga z. ***. ***, në vlerën 40.000 euro dhe 5.000 usd, me aktin noterial nr. ***/***/rep/kol, datë **.9.2016, (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e apartamentit në *** ***)*.

14.10 Subjekti ka bashkëlidhur kontratë huaje nr. ***/*** datë **.9.2016, sipas së cilës shtetasi ***. ***, i ka dhënë në formë huaje subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu një shumë prej 40.000 euro dhe 5.000 usd respektivisht: në muajin gusht 2015 shumë prej 5.000 usd, e cila është dhënë cash, dhe 40.000 euro në muajin mars të vitit 2016, kaluar nëpërmjet bankës. Në kontratatë parashikohet se shumt janë përdorur për blerjen e banesës sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, dt. **.9.2015, sipas kësteve të përshkruara në kontratë. Huaja është dhënë pa interes dhe afati i saj lidhet me shitjen e apartamentit ekzistues sipas çertifikatës së pronësisë, zk *** me nr.pasurie */***+*-**, vol. **, fq.** me sip. 89,95 m² në adresën rruga “*** **”, ap.10, në pronësi të Afrim dhe *** **.

14.11 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se, referuar pasqyrës së lëvizjeve të llogarisë bankare pranë ***, shuma e cila është përdorur si burim për dhënien e huasë subjektit, është depozituar në datë **.01.2010 nga shtetasi ***. ***, në cash në llogarinë e tij, në vlerën 70.000 euro dhe është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën e realizimit të transfertës/huasë 40.000 euro, **.3.2016, drejt llogarisë së subjektit, me përshkrim *“huadhënie për blerje shtëpie”*.

14.12 Subjekti, gjatë hetimit administrativ, lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësit, ka deklaruar se [...] *Nga biseda me shtetasin ***. ***, më është konfirmuar se burimi i ligjshëm i vlerës 70.000 euro së depozituar cash në datë **.01.2010 pranë ***, janë të ardhurat ndër vite nga puna e shtetasit ***. ***, në Mbretërinë e Bashkuar. Në plotësimin e kësaj vlere janë dhe këstet e shlyerjes së huasë së marrë nga bashkëshortja ime vlerën 23.000 usd, vlera 22.600 usd e depozituar më datë **.08.2005 nga *** ***, e cila është tërhequr në datë **.10.2005, si dhe të ardhura të tjera të dërguara dhe sjellë nga shtetasi ***. ***. Vlera prej 22.600 usd pasi është tërhequr më datë **.10.2005 i është dhënë për nevoja familjare shtetasit ***.***. Kjo*

⁴⁸ Subjekti deklaroi se [...] *Në lidhje mospërputhjen me deklaramet në deklaratën vetting dhe vlerës së pagesave të paguara në total, shpjegoj se ka një gabim material në formën se si jam shprehur në deklaramet në lidhje me pagesën e këstit të dytë. Vlera e saktë e paguar nga unë nëpërmjet bankës është 30.000 Euro, ndërkohë që është deklaruar si e paguar në këtë datë vlera 39.952 euro. Ky gabim në deklaramet ka ndodhur për shkak se gjatë hedhjes së të dhënave në deklaratë, gabimisht nga ana ime është vendosur vlera e kredituar nga shtetasi *** ***, që ishte 39.952 Euro dhe jo vlera e debituar shoqërisë “***” sh.p.k, që është 30.000 Euro. Pra vlera e pagesave është: Kësti i parë më datë **.9.2015 shuma 40.000 euro me mandat arkëtimi, kësti i dytë është më datë **.3.2016 shuma 30.000 euro me bankë me përshkrimin “pagesë për blerje shtëpie bazuar në kontratën e porosisë nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.09.2015”, kësti i tretë është më datë **.10.2016 vlera 20.000 Euro me bankë me përshkrimin “pagesë për blerje shtëpie bazuar në kontratën e porosisë nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.09.2015” dhe kësti i fundit është më datë **.10.2016 vlera 2.840 Euro me përshkrimin “Diferenca për përmbushjen e detyrimit blerje shtëpie bazuar në kontratën e porosisë nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë **.09.2015”. Të gjithë këstet sipas kontratës janë 40.000 + 30.000 + 20.000 + 2.840 = 92.840 Euro[...].*

vlerë më pas i është dhënë shtetasit ***, ***, i cili e ka depozituar në bankën *** në datë **.01.2010[...].

14.13 Nisur nga fakti se, referuar shpjegimeve të subjektit, sikundër trajtuar dhe më sipër, duket e paqartë arsyeja e transferimit të shumës 15.297 euro nga z. ***, ***, në llogarinë e subjektit në *** bank në dt. **.10.2005, e cila është përdorur si burim për pagesat e apartamentit në rrugën “**** **”, kur bashkëshortja e subjektit në dt. **.08.2005 (vetëm 1.5 muaj përpara) ka patur likuiditete të disponueshme në vlerën 22.600 usd, por të cilat pretendon se ia ka dhënë shtetasit *** ***, për nevojat e tyre, Komisioni fillimisht nuk ka përfshirë në analizën financiare, vlerën e huasë prej 40.000 euro marrë në vitin 2016, pasi ka vlerësuar se gjatë hetimit nuk u arrit të provohej se vlera e mësipërme i është dhënë/transferuar shtetasit *** *** nga shtetasi ***, ***..

14.14 Lidhur me burimin e deklaruar kursime ndër vite të deklaruara para datës **.12.2014, subjekti, referuar procesverbalit të datës ** Janar 2016 ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, se gjendja e kursimeve cash deri në dt. **.12.2014 ka qenë 1.010.000 lekë. Gjendja cash prej 10.000 euro është shpenzuar për mobilimin e shtëpisë në rrugën “**** **”, diferenca prej 5.000 euro ka qenë gjendje në 31.12.2014.

Në DV-2015, subjekti, si burim për pagesën e këstit të parë të apartamentit në rrugën “**** **” deklaroi se ka shërbyer “Shuma 1.010.000 lekë + 5.000 euro pakësuar CASH, në banesë para datës **.12.2014”, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 bashkëshortja e subjektit deklaroi “Gjendje cash në banesë 15.000 euro”.

14.15 Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes cash deri në vitin 2014, nga deklaratimet periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime cash në vitet 2010; 2011 dhe 2014⁴⁹. Nga analiza e Komisionit kanë rezultuar me vlerë pozitive vetëm vitet 2011 dhe 2014, për këtë arsye vlera e përfshirë në analizë, si burim i ligjshëm, është 890.000 lekë. Ndërsa në lidhje me shumën cash prej 5.000 euro e krijuar para fillimit të detyrës, Komisionit, duke i rezultuar se analiza para fillimit të detyrës është me vlerë negative, ka vlerësuar se subjekti nuk ka patur mundësi ta krijojë gjendjen cash prej 5.000 euro me të ardhura të ligjshme.

14.16 Lidhur me burimin e deklaruar shuma 994,25 USD, tërheqje nga llogaria Afrim Shehu *** bank dhe shuma 1.600 USD, cash të ardhura Kroaci. Në DV-2013 dhe në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura si lektor në Shkollën e Magjistraturës, organizuar nga OPDAT, pranë Ambasadës Amerikane. Vlera 994,13 USD depozituar në dt. **.05.2013”. Në DV-2015 dhe deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga trajnime në 4 faza, organizuar nga OPDAT, pranë Ambasadës Amerikane, në Kroaci, në dt. **.03.2015, **.06.2015, **.11.2015 dhe **.12.2015. Vlera 1.600 usd cash.”

14.17 Sa më sipër, Komisioni nuk ka përfshirë si të ardhura të ligjshme vlerën 994 usd, tërhequr nga subjekti në dt. **.02.2015, pasi ka vlerësuar se në seksion B të kontratës, është specifikuar se përgjegjësia për pagesën e taksave dhe tatimeve për shumën e përfituar është e subjektit të rivlerësimit dhe gjatë procesit nuk u arrit të provohej se janë shlyer detyrimet tatimore për këtë vlerë. Me të njëjtin arsyetim, Komisioni nuk ka përfshirë dhe vlerat e përfituara gjatë vitit 2015 nga trajnimi i organizuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA, në

⁴⁹ 120.000 lekë deklaruar në DV-2010, 240.000 lekë deklaruar në DV-2011 dhe 650.000 lekë në DV-2014.

vlerën 1.197 USD dhe 556 USD në vitin 2016. *Lidhur me burimin kursime gjatë vitit 2015 të konvertuara gjithsej 1.622 euro.* Komisionit⁵⁰, nga analiza e kryer për vitin 2015, i ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë patur mundësi të krijojnë kursime cash gjatë vitit 2015 me të ardhura të ligjshme.

14.18 *Lidhur me burimin të ardhura nga shitja e apartamentit ndodhur në rrugën *** ***, Tiranë, në vlerën 85.000 euro, sikundër është trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit më sipër, Komisionit i ka rezultuar fillimisht pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme në blerjen e kësaj pasurie .*

14.19 Në përfundim, për sa arsyetuar më sipër, për pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “*** **”, burimeve të krijimit të tij dhe mbulimin e kostove të deklaruara të mobilimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi në përfundim të hetimit ka rezultuar se subjekti ka pamjaftueshmëri financiare për pagesat për këstet e apartamentit, në vlerën - 5.276.206 lekë⁵¹.

14.20 Komisioni, pasi ka vlerësuar prapësimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti⁵², lidhur me këtë pasuri, ka vlerësuar se [...]Në përfundim të sa më sipër trajtuar, për pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “*** **”, pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti arriti të përcjellë prova nga të cilat Komisioni vlerësoi se pamundësia financiare është -10.139 euro ose -1.420.557 lekë⁵³[...].

14.21 *Komisioneri Publik*, për sa më sipër trajtuar, lidhur me burimet e ligjshme të pasurisë apartament banimi ndodhur në Tiranë me adresë rruga “*** **” dhe të shumës së deklaruar përdorur për mobilimin e kësaj pasurie në vlerën 11.000 euro, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, pasi:

14.21.1 *Lidhur me mundësinë e huadhënësit, shtetasit ***. **, për të krijuar me burime të ligjshme shumë prej 40.000 euro + 5.000 dollarë, Komisioneri Publik*, referuar akteve në dosje dhe në zbatim të rekomandimit të ONM-së, vlerëson se edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën, lidhur me huadhënësin dhe burimet e ligjshme të tij. Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se kontrata e huasë është nënshkruar me shtetasin ***. **., nga llogaria e të cilit rezulton dhe transaksioni i huadhënies, dhe për rrjedhojë, bazuar në nenin 32, pika 4 të ligjit nr.84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

14.21.2 Gjatë hetimit administrativ, nga subjekti i rivlerësimit, sikundër dhe në rastet e tjera, është pretenduar se burimi i shumëve të marra hua (të shtetasit ***.**, apo ***.**), janë kryesisht të ardhurat nga punësimi i ***. ** dhe jo të ardhurat e huadhënësve. Referuar pretendimeve të subjektit, po ashtu pjesë e depozitës prej 70.000 euro në emër të ***.**, nga e cila është krijuar huaja prej 40.000 euro, është edhe kthimi i huasë së vitit 2005, lidhur ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit ***. **, si dhe shuma 22.600 usd, e cila

⁵⁰ Referohu tabelës nr.13 tek Rezultatet e hetimit administrativ.

⁵¹ Detajuar në tabelën nr. 14 të aktit: “Rezultate të hetimit administrativ”.

⁵² Referohu gjerësisht prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti I rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës.

⁵³ Referohu prgrf. 26.27 i vendimit të arsyetuar.

ndodhej në depozitë të bashkëshortes dhe deklarohet nga subjekti se në vitin 2005 i është dhënë vëllait ***.***. dhe bashkëshortes së tij. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se këto rrethana eventualisht mund të vlerësohen në raport me të dhëna të autoriteteve të inteligjencës financiare të administruara në dosje të Komisionit.

14.21.3 Subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi burimet e ligjshme të huadhënësit ***.***., për të krijuar shumën e deklaruar të dhënë hua 40.000 euro në rrugë bankare dhe 5.000 euro në cash. Bazuar në aktet e paraqitura nga subjekti mbi të ardhurat e shtetasit ***.***., të cilat janë në vlerat rreth 80.000-85.000 lekë/muaj, vlerësohet se ato janë të pamjaftueshme për të mbuluar huanë e dhënë dhe shpenzimet e tij të jetesës.

14.21.4 Pretendimet e subjektit mbi burimin e kësaj huaje nga të ardhurat e shtetasit ***.***., nuk provohen as nga aktet në dosje, pasi nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të shtetasit ***.***., rezulton se vetëm shuma prej rreth 28.905 paund është transferuar nga ***.***. te shtetasi ***.***., në një llogari të ndryshme nga ajo prej ku është dhënë vlera e huasë, që gjithsesi përkon me vitet 2011-2013, pas krijimit të depozitës prej 70.000 euro. Po ashtu, nga verifikimi i akteve në dosje nuk provohet as kthimi i kësaj shume shtetasit ***.***. nga shtetasi ***.***..

14.21.5 Sa më sipër, *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së dhe në mungesë të akteve provuese vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit, shtetasit ***.***., dhe pretendimet e tij, se shuma e dhënë hua nga ky shtetas ka si burim të ardhurat e shtetasit ***.***..Subjekti i rivlerësimit, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të (i) pagesave të kryera në vitin 2015; (ii) burimet e ligjshme të huadhënësit ***.***. për pagesën e kështit të dytë në vitin 2016 në vlerë 40.000 euro, referuar kërkesave të nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) burimeve të ligjshme për shpenzimet e mobilimit deklaruar në vlerën 10.000 euro, nisur nga pamjaftueshmëria financiare e konstatuar për krijimin e kursimeve në cash në vijim.

14.21.6 Lidhur me burimin e deklaruar të *ardhura nga shitja e pasurisë, apartament ndodhur në rrugën “**** **”, Komisioneri Publik*, ka trajtuar në mënyrë të detajuar më lart në këtë ankim problematikat e konstatuara dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme që ka rezultuar për blerjen e kësaj pasurie për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme të blerjes saj, e si rrjedhim dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie, deklaruar si burimi kryesor për blerjen e pasurisë apartament ndodhur në rrugën “**** **”, vlerësohet se nuk plotëson kushtet e parashikuara në nenin 61 pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës.

14.22 Në konkluzion për sa më sipër, *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të aneksit të Kushtetutës.

15 Lidhur me zëra të tjerë të analizës financiare

15.1 Kursimet në cash

15.1.1 Në DV-2009 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *Gjendje cash në banesë, 15.000 euro, pa deklaruar burimin e krijimit.*

15.1.2 Në DV - 2010, bashkëshortja e subjektit deklaroi: *Nga të ardhurat e pagës vjetore janë kursyer një shumë prej 500.000 lekë. Ndërsa një shumë prej 200.000 lekë dhe depozita e bashkëshortit prej 7.000 Euro kanë shërbyer për shlyerjen e huasë së mbetur në shumën 11.500 USD. Kursim në llogarinë rrjedhëse në bankë në shumën 320.000 lekë dhe cash në shumën 120.000 lekë.*

15.1.3 Në DV – 2011, bashkëshortja e subjektit deklaroi: *Nga të ardhurat e pagës si dhe shuma e shitjes së automjetit TR*** janë kursyer në shumën prej 1.200.000 lekë. Është hapur dhe një llogari kursimi pranë *** Bank, ku deri në dt. **.12.2011 janë kursyer 100.145 lekë. Kursim në llogarinë rrjedhëse në *** bank në shumën 960.000 lekë dhe cash në shumën 240.000 lekë dhe llogari kursimi 100.145 lekë.*

15.1.4 Në DV - 2014, subjekti deklaroi: *Kursim nga të ardhurat nga paga 650.000 lekë (me shkrim dore shtuar: cash).*

15.1.5 Në DV - 2015, subjekti deklaroi: *Kursime nga paga gjate vitit 2015 në vlerën 500.000 lekë. Gjendje cash në banesë 400.000 lekë.*

15.1.6 Në DV - 2016 dhe në deklaratën Vetting nuk ka deklarim në lidhje me kursime cash.

15.1.7 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datë **.01.2016, pyetur lidhur me kursimet në cash, subjekti ka deklaruar se: *“Gjendja Cash në banesë në dt. **.12.2014 ka qenë në shumën 1.010.000 lekë. Ndërsa gjendja cash prej 10.000 euro është shpenzuar për mobilimin e shtëpisë në rugën “*** ***”. Diferenca prej 5.000 euro ka qenë gjendje në dt. **.12.2014.”*

- Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e proves, pasi nga analiza financiare ka rezultuar se⁵⁴[...] *Duket se subjekti ka pamundësi financiare në krijimin e gjendjes cash me burime të ligjshme të deklaruara para fillimit të detyrës në vlerën 15,000 euro dhe në vitet 2010, 2014, 2015 në vlerë totale prej - 3.067.550 lekë (15.000 euro + 1.010.000 lekë)⁵⁵. Duket se subjekti ka mospërputhje të*

⁵⁴ Nisur nga fakti se nga analiza financiare e kryer deri në vitin 2009, lidhur me deklarinimin e parë të subjektit para fillimit të detyrës, ka rezultuar se subjekti nuk mbulonte me burime të ligjshme investimet dhe kursimet e deklaruara, Komisioni në analizën financiare të kryer, nuk ka mbartur gjendjen e kursimeve cash të deklaruar prej 15.000 euro nga bashkëshortja e subjektit, për vitet në vijim.

⁵⁵ Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ ka vlerësuar se: Në lidhje me burimin e gjendjeve të kursimeve referuar analizës financiare gjithëpërfshirëse rezultoi se subjekti nuk ka patur mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme gjendjen e kursimeve cash të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, pasi rezultati financiar për këtë periudhë është – 7.967.469 lekë, në vitin 2010 në vlerën – 120.000 lekë, në vitin 2014 në vlerën -650.000 lekë dhe në vitin 2015 në vlerën -400.000 lekë. Pra në total pamundësia për krijimin e gjendjeve cash të kursimeve rezultoi në vlerën -3.067.550 lekë.

deklarimit në vetting me gjendjen e kursimeve cash të rezultuara nga deklaratat periodike DV 2009-2016, në vlerën 400.000 lekë[...].

15.1.8 Komisioni, në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, lidhur me mënyrën e deklaratimit të kursimeve në cash ndër vite, ka vlerësuar se: Përsa i përket kursimeve të deklaruara në deklaratën e parë para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente vetëm shumën prej 379.670 lekë. Bazuar në praktikën e Kolegjit, është vlerësuar se analiza financiare duhet të rishikohet dhe duhet të përfshihen si kursime cash në vitin vijues vetëm shtesat e kursimeve cash, për të cilat është provuar burimi i ligjshëm në periudhën para marrjes së detyrës. Për shtesat e deklaruara në vitet 2010 – 2015, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamundësi financiare për krijimin e tyre në vitet 2010, 2014 dhe 2015 me burim të ligjshëm, Komisioni ka vlerësuar se metodologjia e ngritur tashmë për deklaratimet e kursimeve cash, duke i konsideruar deklaratat periodike si provën e vetme të tyre, duhet të zbatohet edhe në analizën financiare të subjektit.

15.1.9 Pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, Komisioni arriti në konkluzionin se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, u reflektuan në analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën totale - 3.144.31 lekë⁵⁶.

15.1.10 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me trajtimin e kursimeve në cash në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, pasi:

15.1.11 Sikundër ka rezultuar në trajtimin e pasurive më sipër (*apartament në rrugën “***” dhe garazh me të njëjtën vendndodhje*), subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe investimeve të deklaruara në DPFD 2009, përfshirë këtu dhe krijimin e gjendjes cash të deklaruar në shumën 15.000 euro. Rrjedhimisht këto kursime nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve në vitet në vijim.

15.1.12 Përsa i përket deklaratimeve të kursimeve në cash në DV 2009-2016, vlerësohet se ato janë kontradiktore dhe nuk përputhen me deklaratimet e subjektit në prapësime ndaj rezultateve të hetimit administrativ dhe deklaratimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në janar 2016⁵⁷, çka reflektohet dhe në mospërputhje pretendimeve mbi gjendjen e kursimeve në cash në fund të vitit 2014, midis deklaratimit në procesverbalin në ILDKPKI (ku deklarohet se gjendja në cash në këtë datë është 1.010.000 lekë + 5.000 euro) dhe deklaratimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ (deklaruar 2.398.597 lekë).

15.1.13 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me

⁵⁶ Referohu prgrf. 36.9 deri në 37.2 të vendimit të arsyetuar, specifikisht përpara marrjes së detyrës në vlerën -1.677.880 lekë dhe pas detyrës në vlerën totale -1.466.451 lekë, rezultuar në vitin 2010 vlera -170.764 lekë, në vitin 2014 vlera - 426.691 lekë dhe në vitin 2015 vlera - 868.996 lekë.

⁵⁷ Në të cilin subjekti ka deklaruar se ka pakësuar kursimet në cash për mobilimin e apartamentit në vitet 2010-2011 ndërkohë që në prapësime të rezultateve të hetimit administrativ subjekti ka pretenduar mbartjen e kursimeve në cash të paktën deri në fund të vitit 2014, paraqitur në formë tabelare në fq. 37 të prapësimeve.

kursimet në cash ndër vite dhe shpenzimet e deklaruara me burim nga këto kursime, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

15.2 Shpenzimet e evidentuara nga karta e kreditit

15.2.1 Lidhur me rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni, vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, ky i fundit me prapësimet e depozituara ka kundërshtuar, ndër të tjera, edhe zërin: “shpenzime me kartë krediti”, pasi ka pretenduar se një pjesë e tyre janë kryer për persona të tretë apo dhe dublimi i tyre si rezultat i përlllogaritjes të zërave përkatës edhe në shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimeve.

15.2.2 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar bindëse pretendimet e subjektit, ka rishikuar analizën financiare dhe ka vlerësuar që në analizën përfundimtare të mos përfshijë shpenzimet e evidentuara nga karta e kreditit të bashkëshortes së subjektit.

15.2.3 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, për sa më sipër ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se, në mbështetje të pretendimeve të subjektit, nuk duhet të përfshihen në shpenzime të subjektit, vetëm ato transaksione bankare që mund të konfirmohen/identifikohen që janë kryer për të tretët, apo ato transaksione që identifikohen si të kryera për mbulimin e kostove të udhëtimit të deklaruara nga subjekti⁵⁸. Ndërsa, përsa i përket shpenzimeve të evidentuara nga lëvizjet e llogarisë bankare, që lidhen me pagesa të ndryshme si blerje online, etj., të cilat rezultojnë se nuk janë pjesë zërave përbërës të përcaktuara nga INSTAT për përlllogaritjet e kostove të jetesës, vlerësohet se ato duhet të pasqyrohen në analizë si shpenzime shtesë të familjes.

15.3 Analiza financiare për periudhën 2003-2016

15.3.1 Komisioni, në përfundim me rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga analiza financiare e periudhës dhjetor 2009-2016, rezulton me vlerë negative prej – 3.102.240 lekë, ndërsa analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën – 12.826.098 lekë. (Në total për të dyja periudhat diferenca negative ka rezultuar në vlerën - 15.928.338 lekë.)

15.3.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, së bashku me papësimet për çdo zë, ka depozituar dhe një analizë financiare të rishikuar.

15.3.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, ka arritur në konkluzionin, se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm (trajtuar më sipër për secilin zë), dhe i ka reflektuar ato në analizën financiare, nga ku në përfundim i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën totale - 3.144.331 lekë⁵⁹.

⁵⁸ Psh. për vitin 2014 duhet të zbriten nga shpenzimet e evidentuara me kartë kredit shumë e evidentuara kredituar nga shtetasi *** ** në vlerën 48.260 lekë. Gjithashtu kostot e përlllogaritura për shpenzimet e udhëtimit duhet të zbriten për pagesën e kryer me kartë krediti në favor të “*** **”. Për vitin 2015 shumë e shpenzuara për udhëtime të evidentuara si pagesa me kartë duhet të zbriten nga zëri shpenzime udhëtimi me qëllim mosdublimin e tyre.

⁵⁹ Specifikisht përpara marrjes së detyrës në vlerën -1.677.880 lekë dhe pas detyrës në vlerën totale -1.466.451 lekë, rezultuar në vitin 2010 vlera -170.764 lekë, në vitin 2014 vlera - 426.691 lekë dhe në vitin 2015 vlera - 868.996 lekë.

15.3.4 Në përfundim për kriterin e pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se [...] *Trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit [...].*

15.3.5 *Komisioneri Publik*, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

15.3.6 *Komisioneri Publik*, përveç sa më sipër trajtuar, në mënyrë të detajuar në secilin shkak ankimi, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të justifikojë burimet e ligjshme të tij dhe personave të lidhur e të tjerë të lidhur me të, për krijimin e pasurive, mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve edhe për vitet 2014-2016, për një pamjaftueshmëri financiare përtej asaj të konstatuar nga Komisioni⁶⁰.

15.3.7 Për më tepër, nga vendimi nr. 762/2024 i Komisionit, rezulton se edhe në skenarin më të mundshëm garantist, në të cilin Komisioni ka konsideruar të gjitha prapësimet e subjektit të rivlerësimit, sërish diferenca negative e rezultuar kalon kufijtë e proporcionalitetit dhe standartit Kushtetues të vendosur në jurisprudencën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të aneksit të Kushtetutës.

IV.B Për vlerësimin e aftësive profesionale

16 Hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, është bazuar në administrimin e të gjithë burimeve të vlerësimit, ndër të tjera dhe në vlerësimin e denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese.

16.1 Në vijim të përfundimeve të arritura nga Komisioni, në shqyrtim të shkaqeve të denoncimeve, nisur dhe nga fakti që jurisprudenca e Kolegjit ka theksuar rëndësinë që ka në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i denoncimeve nga publiku dhe rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së çmon se

⁶⁰ Bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi nga vëzhguesit ndërkombëtar, aktit me nr. 327/1 prot., datë 30.9.2024, në rast të moskonsiderimit të huas prej 40.000 euro në vitin 2016 si rezultat i mungesës së provimit të burimeve të ligjshme të huadhënësit ***,***, diferenca negative do të thellohej ndjeshëm në masën rreth – 7.3 milionë për periudhën 2014-2016, referuar tabelës fq. 24-25 të rekomandimit.

përveç sa konstatuar nga Komisioni⁶¹, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa trajtuar në vijim:

17 Denoncim i shtetasit *.***.** Nga aktet rezulton se pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, është administruar denoncimi i shtetasit ***.***., protokolluar me nr.***, datë **.8.2023. Ky shtetas, ndër të tjera referon se prokuroria e Durrësit ka patur në hetim një çështje penale ndaj shtetasit ***.***., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “*Trafikimit të lëndëve narkotike*”. Hetimet për këtë çështje janë kryer nga prokurori i prokurorisë së Durrësit ***.***., i cili ka vendosur në përgjim disa numra telefonash që u përkisnin disa personave të ndryshëm.

17.1 Denoncuesi pretendon se i arrestuari ***.***. ka komunikuar me një të afërm të tij, shtetasin ***.***. dhe ky i fundit ka komunikuar me babain e ***.***. (shtetasin ***.***.), që të lidhej me prokurorin Afrim Shehu, i cili do ndërhynte për lirimin e djalit shtetasit ***.***. nga burgu në këmbim të rryshfetit të paligjshëm ndaj gjyqtares së Gjykatës së Apelit Durrës ***.***.

17.1 Gjatë punës në terren, shpjegon denoncuesi, u konstatua se personi që shtetasi ***.***. do të kontaktonte për dorëzimin e parave të destinuara për gjyqtaren ***.***., ishte prokurori i Prokurorisë së Durrësit, Afrim Shehu. Sipas denoncuesit, shtetasi ***.***. dhe prokurori Afrim Shehu janë takuar në një pikë të karburantit në autostradën Tiranë-Durrës dhe grupi hetimor i policisë e ka dokumentuar këtë takim me foto.

17.2 Nga aktet e administruara rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me shkresën nr.***/* prot., datë **.9.2023, në përgjigje të kërkesës së Vëzhguesit Ndërkombëtar të ONM-së, ka informuar se [...] *me datë **.4.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka regjistruar procedimin penal me nr.***, në ngarkim të shtetasit ***.***., i dyshuar për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/a i K.Penal. Me datë **.3.2021, ky procedim është dërguar për gjykim ndaj të pandehurit ***.***. dhe rezulton që me vendimin gjyqësor me nr.*** datë **.11.2022, Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës, ka deklaruar fajtor të pandehurin duke e dënuar me 12 vjet burgim.[...].* Bashkëlidhur, kësaj shkrese janë dërguar kopje të fashikujve të këtij procedimi penal.⁶²

17.3 Nga aktet e këtij procedimi, ka rezultuar se në *Raportin e vëzhgimit të datës **.5.2020*, mbajtur nga punonjësit e policisë gjyqësore⁶³, në funksion të procedimit penal nr. ***/2020, ndër të tjera rezulton se [...] *shtetasi ***.***., babai i shtetasit të proceduar ***.***. aktualisht në burg subjekt i këtij procedimi, komunikon në telefon me një person të panjohur për momentin , i cili ka kërkuar të takojë shtetasin ***.***.[...].*

⁶¹ Duke i vlerësuar të mjaftueshme shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, vendos në vëmendje të Kolegjit dhe gjetjet e Komisionit në denoncim të tjera për të cilat i ka kaluar barrë prove. Në rastin e dy denoncimeve të shtetasit ***.***., protokolluar me nr. denoncimet nr.*** prot, datë **.1.2018 dhe nr.*** prot, datë **.5.2018, Komisioni ka arritur në përfundimin se [...] *Komisioni çmon se në rastin konkret gjetjet e gjykatës lidhur me mangësitë e subjektit në kryerjen e veprimeve hetimore përbëjnë shkelje në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Kjo çështje do të vlerësohet në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, së bashku me gjetjet e tjera të konstatuara[...].*

⁶² Nga aktet rezulton se hetimi për këtë çështje i është ngarkuar prokurorit të Durrësit, ***.***., i cili, ashtu sikurse ka pretenduar dhe denoncuesi, rezulton se për nevoja hetimi ka vënë në përgjim disa individë dhe numra telefoni.

⁶³ Punonjësit e Policisë ***.***.; ***.***.; ***.***.; dhe ***.***.

17.4 Oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë siguruar me detaje dhe me foto itinerarin që bën shtetasi ***.***, për t'u takuar me shtetasin e identifikuar më pas si shtetasi ***.***, të cilët pasi janë takuar, kanë udhëtuar së bashku në të njëjtën makinë dhe janë ulur tek bordura përbri autostradës në pjesën e karburantit “***”. Oficerët e policisë gjyqësore, referojnë se [...] *rreth orës 15.08 në karburant futet një automjet i markës Volkswagen tip Golf., me targa AA***, i cili është afruar në drejtim të shtetasve ***.*** dhe ***.***... Ky automjet rezulton se është në pronësi të shtetasit A.Sh.(subjektit të rivlerësimit).Pasi ka ndaluar në vendin ku ishin ulur këta të dy, shtetasi ***.*** ka hipur në vendin e parë të pasagjerit dhe pak çaste më mbas ka hipur në sediljen e pasme nga krahu i pasagjerit edhe shtetasi ***.***.[...].*

17.5 Oficeri i policisë gjyqësore, ***.***, në vijim, me datë **.5.2020, ka informuar prokurorin e çështjes, se nga interceptimet telefonike ka rezultuar se shtetasi ***.*** dhe shtetasi ***.***, kanë pasur komunikime thuajse çdo ditë, [...] *ku shtetasi ***.*** pyet shtetasin ***.***, mbi ecurinë e procesit gjyqësor ndaj djalit të tij, ndërsa shtetasi ***.***, e pyet sa persona janë dhe kur është gjyqi dhe kush është relatori. Gjithashtu oficeri i policisë, ka informuar se rezulton se shtetasi ***.***, me të gjithë personat që komunikon në telefon duket optimist dhe ju thotë atyre nuk ka prova, do ta nxjerrin *** (***.***.)[...].*

17.6 Vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, me shkresën nr. *** prot., datë **.9.2023, drejtuar relatores së çështjes, me objekt “*Informacion për dyshime për korrupsion/ndikim të prokurorit A.Sh.*”, i ka sugjeruar Komisionit t’i dërgojë subjektit të rivlerësimit një pyetësor shtesë, duke i kërkuar të qartësojë disa rrethana faktike⁶⁴.

17.7 Komisioni, nëpërmjet postës elektronike “e-mail” datë **.10.2023, me pyetësorin nr.**, i ka kërkuar subjektit të sqarojë nëse [...] *(1) subjekti ka njohje me shtetasin ***.*** dhe ***.*** dhe (2) cili është raporti që ai ka me këta persona. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të shpjegojë nëse është takuar me këta persona dhe nëse po cili ka qenë qëllimi i takimit[...].*

17.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr.4, datë **.10.2023, ndër të tjera⁶⁵ ka dhënë shpjegimet përkatëse që ka çmuar të nevojshme.

17.9 Vëzhguesi Ndërkombëtar i ONM-së, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.10.2023, në vijim të shkresës me objekt “*Informacionit për dyshime për korrupsion/ndikim të prokurorit A.Sh.*”, i ka përcjellë relatores së çështjes, të dhëna më të detajuara⁶⁶, mbi transkriptimet e bisedave telefonike të shtetasit ***.*** me shtetasin ***.***. Nga bisedat telefonike, rezulton se shtetasi ***.***, në datën **.5.2020, ditën e takimit me subjektin e rivlerësimit, i kërkon

⁶⁴ Vëzhguesi Ndërkombëtar, ka sugjeruar këto pyetje. (1) Cili ishte qëllimi i takimit; (2) Pse pranoi të takohej me babanë e një personi në arrest në burg dhe me ***.***; (3) Çfarë raporti kishte në atë kohë me ***.*** dhe ***.***. (4) Si u organizua takimi (nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me këta dy persona apo indirekt, nëpërmjet personave të tjerë) duke specifikuar në detaje modalitetet; (5) Cila ishte përmbajtja e këtij takimi; (6) Cili ka qenë rezultati i takimit dhe nëse i është kërkuar të bëjë diçka në lidhje me procedimin penal të shtetasit ***.***; (7) Nëse subjekti i rivlerësimit, pas takimit, ka qenë në kontakt, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ***.*** dhe pse; (8) Nëse ka folur me kolegun ***.***, për takimin dhe kontaktet që ka pasur me ***.***.

⁶⁵ Shih për detaje pyetësorin nr.4.

⁶⁶ Referohuni fashikullit IMO, në dosje të Komisionit.

shtetasit ***.***., të takohem me “*atë*”. Shtetasi ***.***., në një telefonatë të mëvonshme, po gëratë kësaj dite, i thotë se do e takojnë “*atë*”, më vonë rreth orës 14-14.30.⁶⁷

17.10 Komisioni, pasi ka administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se [...] *deri në këtë fazë të hetimit nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit*[...].

17.11 *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në analizë të rastit të sipërtrajtuar, vlerëson se, nga aktet në dosje, rezultojnë të provuara disa rrethana që duhet të vlerësohen nga Kolegji, për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit, z.Afrim Shehu, për sa në vijim:

17.12 Nga aktet e procedimit penal nr. ***/2020, rezulton se informacionet e dhëna nga denoncuesi, referojnë situata dhe rrethana faktike, të cilat duket se përputhen dhe me rrethanat e prapësuar në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton e dokumentuar që subjekti i rivlerësimit është takuar me shtetasit ***.***. (*kushëriri i subjektit*) dhe shtetasin ***.***. (*babai i shtetasit ***.***. në atë moment në burg, i akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, kryer në bashkëpunim*) dhe takimi lidhej pikërisht me procedimin penal ndaj shtetasit ***.***.

17.13 Nga transkriptimet e bisedave telefonike, rezulton se në bisedat mes shtetasve ***.***. dhe ***.***. , lidhur me ecurinë e procedimit penal të shtetasit ***.***., ato i referohen takimeve me një shtetas, që e cilësojnë “*Atë/Ai*”. Ky shtetas, nuk duket të jetë vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi ***.***., pasi ashtu sikurse rezulton në *procesverbalin mbi transkriptimin e bisedave telefonike të shtetasit ***.***., datë **10.2020*, emri i vëllait të subjektit përmendet i plotë. Nga aktet rezulton se emri i vëllait të subjektit të rivlerësimit, që pretendohet se do realizonte mbrojtjen si avokat i shtetasit ***.***., në bisedat e dokumentuara, përmendet shumë më vonë në kohë nga takimi me subjektin e rivlerësimit që daton më ***5.2020*, dhe pretendimi se ky shtetas do realizonte mbrojtjen, nuk mbështetet nga asnjë akt formal i procedimit penal nr.***/2020.

17.14 Subjekti i rivlerësimit, në rrethanat e mësipërme, më së paku, duket se ka shfaqur një qasje të papërshtatshme në takimin me babain e një personi të dyshuar për veprën penale të “*Trafikimit të lëndëve narkotike*”, parashikuar nga neni 283/a i K.Penal, në një procedim penal të trajtuar nga kolegu i tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në juridiksionin e së cilës subjekti ushtronte detyrën, në një kohë kur bisedat e transkriptuara tregojnë që shtetasit ***.***. dhe ***.***., *po bënin përpjekje për mbylljen e kësaj çështje si dhe lirim nga paraburgimi të të pandehurit ***.***.*, që nga aktet rezulton se ka ndodhur më pas në kohë nga takimi.⁶⁸

⁶⁷ Vëzhguesi Ndërkombëtar shënon se në këtë rast, se në këtë rast, me siguri, referimi “*Ai/atë*”, ka të bëjë me subjektin e rivlerësimit, për sa kohë, shtetasi ***.***. dhe ***.***. takojnë subjektin po të njëjtën ditë. Në bisedat e tjera të transkriptuara, po ashtu, këto shtetas referojnë gjithmonë, një shtetas të tretë “*Ai/Atë*”.

⁶⁸ Nga aktet e administruara, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***/* dt.**.10.2021, ka vendosur të pranojë kërkesën e të pandehurit ***.***., për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg”, në “Arrest në shtëpi”. Prokurori i çështjes, ka vlerësuar se kërkesa është e ligjshme dhe duhet pranuar.

17.15 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vendimin nr.***, datë **.11.2022⁶⁹, ka vendosur të dënojë me 12 vjet burgim shtetasin ***.***.⁷⁰ për veprën penale “Trafikim të lëndëve narkotike, në bashkëpunim”, ndër të tjera duke arsyetuar se [...] *Gjatë hetimeve paraprake janë përgjuar me vendim Gjykate disa numra telefoni të të afërmeve të të pandehurit dhe lidhjeve të tyre shoqërore. Nga analizimi i tyre konstatohen përpjekje për mbylljen e kësaj çështje si dhe lirim nga paraburgimi të të pandehurit ***.***.[...];*

17.16 Këto rrethana në konsideratë dhe të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit, mbi arsyet e takimit me këta shtetas [...] *pasi kishin nevojë për të marrë vëllain si avokat për një çështje në Gjykatën e Apelit Durrës[...], përbëjnë një sjellje që në këndvështrimin e një vëzhguesi të jashtëm ndikojnë negativisht në perceptimin për favorizim të mundshëm nga njerëzit e drejtësisë ndaj autorëve të veprave penale, çka bën që besimi i publikut të cënohet referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 75 i ligjit nr.84/2016.*

17.17 Në përfundim, *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, bazuar në aktet në dosje, vlerëson që edhe pse nuk mund të provohet nga hetimi administrativ përfshirja e subjektit dhe roli i tij i drejtëpërdrejtë në procedimin penal nr. ***/2020⁷¹, për sa më sipër trajtuar, mbetën të dokumentuara disa rrethana faktike si *koha, vendi dhe mënyra e takimit me shtetasit e përfshirë në procedim*, të cilat më së paku, bien ndesh me sjelljen që duhet të ketë një prokuror, bazuar në *Standardet etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit*, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.⁷²

18 Denoncim i shtetasit *. ***.**⁷³ Ky shtetas pretendon se ka paraqitur një kallëzim në Prokurorinë Durrës në vitin 2014, e cila më pas ka regjistruar procedimin penal me nr. *** datë **.11.2014, procedim i cili vazhdon të jetë akoma në prokurori për të hetuar 2-3 dokumenta që janë apo jo të fallsikuara. Shtetasi ***.***., pretendon se hetimi është shtyrë me dashje nga subjekti i rivlerësimit. Tashmë dosja e tij është marrë në shqyrtim nga një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar të bëjë ekspertime ligjore të dy dokumentave të dyshuara.

18.1 Nga aktet e administruara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë **.11.2014, për veprën penale “*Falsifikimi i dokumentave*”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal.

⁶⁹ Ky konstatim është bërë dhe nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës, në vendim nr.***, datë **.11.2022, fq.17 të tij, me të cilin ka dënuar shtetasin ***.***., me 12 vjet burgim , për kryerjen e veprës penale parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal.

⁷⁰ Prokuroria ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit ***.***., për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

⁷¹ Nga aktet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të shpjegimeve shtesë të pyetësorit nr.4, duket se Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, mbi bazën e informacionit të referimit të veprës penale nga Policia Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr.*** për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/c i K.Penal, si rezultat i informacioneve të marra në kuadër të hetimeve të procedimit penal nr.***/2020. Prokuroria e Posacme Kundër Krimin të organizuar dhe Korrupsionit, ka shpallur moskompetencën, pasi ka vlerësuar se vepra penale penale e kallëzuar krijon dyshim për ekzistencë të elementëve të veprës penale “Mashtrimi, parashikuar nga neni 143/1 i K.Penal.

⁷² Neni 6/Pastërtia e figurës.” Prokurori sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e prokurorisë. Sjellja dhe qëndrimi i prokurorit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek sistemi i prokurorisë.”

⁷³ Protokolluar në Komision si Denoncim nr.*** prot, datë **.11.2023.

18.2 Subjekti i rivlerësimit me urdhërin e datës **.7.2015, ka vendosur *Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.***, datë **.11.2014*, për veprën penale “*Falsifikimi i dokumentave*” parashikuar nga neni 186 i K.Penal. Ky vendim është ankimuar nga shtetasi ***.***.

18.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.**, datë **.3.2021, ka vendosur: [...] *Pranimin e kërkesës së ankuesit ***.***. Revokimin e vendimit datë **.7.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me të cilin është vendosur: Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.*** datë **.11.2014, për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal[...].*

18.4 Subjekti i rivlerësimit, me datë **.4.2021, me urdhërin “*Për delegimin e veprimeve hetimore*”, ka urdhëruar Oficerin e Policisë Gjyqësore, për kryerjen e veprimeve hetimore, në lidhje me procedimin penal nr. **, datë **.11.2014, rifilluar më datë **.4.2021. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.4.2024, ka informuar subjektin e rivlerësimit se procedimi penal nr. ***/2014, i rifilluar me **.3.2021, me kallëzues shtetasin ***.***., rezulton të jetë ende nën hetim.

18.5 Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të japë shpjegime dhe të depozitohet prova në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016, për të vërtetuar të kundërtën e pretendimeve të ngritura nga denoncuesi në ankimin e tij.

18.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera ka shpjeguar se [...] *Pas hetimeve të kryera është konkluduar se për dokumentin “akt adoptimi me nr. **, datë **.9.1939 i noterit publik ***. **,” nuk provohej se është i falsifikuar dhe është proceduar me pushimin e hetimeve. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit ***.***, i cili nuk rezulton ta ketë kundërshtuar në rrugë gjyqësore. Shtetasi ***.** në datën **.2.2020, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Durrës me kërkesë për revokimin e vendimit të datës **.7.2015 për pushimin e hetimeve, me arsyetimin se kishte zbuluar të dhëna të reja. Gjykata me vendimin nr. **, datë **.3.2021, ka vendosur revokimin e vendimit datë **.7.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe rifillimin e hetimeve të këtij procedimi penal. Në datën **.4.2021 është administruar vendimi i Gjykatës për fillimin e hetimeve. Është urdhëruar policia gjyqësore për të kryer hetimet e nevojshme sipas urdhrit të delegimit të datës **.4.2021. Me shkresën nr. ***/* prot., datë **.4.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është konfirmuar se procedimi penal nr. **, datë **.11.2014, që bën fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal, rezulton të jetë ende nën hetim[...].*

18.7 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se subjekti nuk argumentoi bindshëm arsyet e mosveprimit të tij lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore, por duke e vlerësuar këtë çështje në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, në kushtet kur kjo çështje është ende nën hetim, nuk mund të vlerësohet në kuadër të vlerësimit profesional.

18.8 *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se ashtu sikurse ka vlerësuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe nuk dha shpjegime bindëse, lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore dhe zvarritjen e procesit.

18.9 *Komisioneri Publik*, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, vlerëson se procedimi penal nr. ***/2014, përmban rrethana që mund të vlerësohen për efekt të procesit të rivlerësimit të z. Afrim Shehu, pasi në kuptim të dispozitave procedurale, asnjë vlerësim që organet e rivlerësimit bëjnë në këtë rast, nuk afekton vendimmarrjen për këtë çështje, për më tepër që vlerësimi në çdo rast u referohet treguesve të kriterit të aftësive profesionale, pa marrë përsipër të gjykohet mbi korrektësinë e vendimmarrjes.

18.10 Nga aktet rezulton se nga urdhëri i datës **.4.2021, i subjektit të rivlerësimit që urdhëron oficerin e policisë gjyqësore, për të kryer veprime hetimore, deri në *Korrik të vitit 2023 (kur subjekti është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë)*, kanë kaluar më shumë se dy vite pa arritur në një përfundim, në kundërshtim me parashikimet e nenit 324 të K.Pr.Penale, rrethanë e cila mbetet e pandikuar nga ecuria procedurale apo rezultati përfundimtar i çështjes.

18.11 Subjekti i rivlerësimit, si personi përgjegjës për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, nuk dha shpjegime bindëse mbi moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale, brenda afatit kohor të përcaktuar, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

19 Denoncim i shtetases ***. ***. ⁷⁴. Kjo shtetase, ngre pretendime ndaj gjyqtarit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrësit ***.*** dhe subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, për të cilin pretendon se nga ky i fundit janë bërë shkelje flagrante duke vendosur mosfillimin e procedimit penal nr.***/2018, ndërkohë që gjyqtari ***.*** ka rrëzuar ankimin e kallëzueses ***. ***, të ushtruar kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.***/2018 të, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

19.1 Nga aktet e administruara nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës⁷⁵, lidhur me fashikullin e procedimit penal nr.***/2018 ka rezultuar se shtetësja ***. ***, ka depozituar kallëzim penal për veprën penale të “*Falsifikimi të dokumentave*”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal, në ngarkim të një grupi studentësh të Universitetit *** ***, Durrës, kallëzim që i është caktuar për trajtim subjektit të rivlerësimit.

19.2 Nga hetimi administrativ, Komisioni ka konstatuar që kërkesat e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit, Afrim Shehu, për pushimin e çështjes nr.***/2018, janë refuzuar 3 herë nga Gjykatat e dy shkallëve, *për moskryerje hetimesh të plota dhe për mospërmbushje detyrash të lëna nga gjykata në kundërshtim me nenin 329/b i K.Pr.Penale*. Sa më sipër, Komisioni, i ka kaluar subjektit, barrën e provës.

19.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, duke iu referuar rrethanave të çështjes, ndër të tjera ka shpjeguar se [...] *Së pari, ankesa nr. ***, datë **.7.2018, në emër të 38 studentëve, nuk ka ekstremitetet e një dokumenti për t’u marrë në mbrojtje nga neni 186 i Kodit Penal. Ky ka qenë shkak që në datën **.1.2018 subjekti ka vendosur mosfillimin e hetimeve, pasi konflikti zgjidhej në Gjykatën Administrative nëpërmjet kundërshtimit të aktit administrativ. Së dyti,*

⁷⁴ Denoncim nr.***/ prot, datë **.5.2018 e shtetases ***. ***. bërë nga avokati i saj ***.***.

⁷⁵ Përgjigja e Prokurorisë Durrës me nr.***/* prot, datë **.10.2023 dhe nr.***/* prot datë **.10.2023

vendimi nr. * i Këshillit të Etikës është bazuar vetëm në thëniet e 5 studentëve, të cilët kishin dëshmuar pranë këtij Këshilli gjatë procesit administrativ për dhënie mase disiplinore ndaj shtetases ***.***. Ky vendim është akt administrativ dhe, si i tillë, mund të kundërshtohet në rrugë gjyqësore. Së treti, policia gjyqësore ka kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore dhe, në pamundësi objektive për të identifikuar të gjithë studentët të cilët kishin mbaruar studimet dhe ishin larguar jashtë shtetit, ka relatuar dhe nga subjekti është kërkuar pushimi i hetimeve. Së katërti, kërkesat e prokurorit për pushimin e hetimeve janë shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar, i cili, në përfundim, me vendimin nr. **-2021-***/**, datë **.7.2021, ka pranuar arsyetimin e subjektit se fakti nuk përbën veprë penale, duke vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. **/2018, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës[...].

19.4 Komisioni, në përfundim, ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka mbështetur vendimet e tij në argumente ligjore dhe në bindjen e tij të brendshme. Gjithashtu, nga ana procedurale, subjekti ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke kryer hetime të mëtijshme ashtu siç specifikohet në vendimet gjyqësore në përputhje me shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 329 të K. të Pr. Penale dhe në mënyrë vijuese ka marrë përsëri vendim pushimi të çështjes. Sa më sipër, shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe, për pasojë, nuk përmbajnë elemente që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

19.5 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, lidhur me denoncimin e shtetases ***.***., vlerëson se ka elementë që duhen vlerësuar nga Kolegji, për efekt të procesit të rivlerësimit, që lidhen me sjelljen e prokurorit kundrejt detyrimeve që burojnë nga vendimet e gjykatës në rolin e organit kontrollues të veprimtarisë hetimore. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme, në shmangje të zbatimit të detyrimeve që vijnë nga vendimet gjyqësore, për të përmbyllur hetimin në mënyrë të plotë, duke afektuar indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

20 Në përfundim, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, për sa më sipër trajtuar në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit e përcaktuar për vlerësimin e sjelljes së magjistratëve, çmon se gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, janë të tilla që bien ndesh me vlerat themelore të pritura nga një magjistrat, siç parashikohet në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016⁷⁶, dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magjistratëve, si brenda ashtu edhe jashtë sistemit gjyqësor⁷⁷. Kjo përfshin parime si paanësia, integriteti dhe shmangia e konfliktit të interesit, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e besimit dhe besueshmërinë e sistemit gjyqësor, të cilat bëjnë që subjekti të gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61 pika 5 e ligjit nr.84/2016.

⁷⁶ [...] 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.[...]

⁷⁷ <https://rm.coe.int/168074738b> [...] 6. Prokurorët duhet të respektojnë standardet më të larta etike dhe profesionale, duke u sjelluar gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe objektive. 97. Prokurorët duhet të fitojnë besimin e publikut duke treguar një sjellje shembullore në të gjitha rastet. Ata duhet të trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë, të barabartë, me respekt dhe mirësjellje. Gjithashtu, ata duhet të respektojnë gjithmonë standardet më të larta profesionale dhe të ruajnë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre, duke vepruar gjithmonë me integritet dhe kujdes. [...]

V. Kërkimi i ankimit

21 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

21.1 Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

21.2 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

21.3 Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

21.4 Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu.

KOMISIONERI PUBLIK


Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtarë (VN) të ONM-së, nr. 327/1 prot., datë 30.9.2024.



International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Prot. No. 327/11

Tirana, 30/09/2024

To the

Public Commissioners

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 6

Tirana

Albania

Case Number **DC-P-DUR-1-04**

Assessee **Afrim Shehu**

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

According to

Article B, par. 3, point c of the Constitution of the Republic of Albania (hereinafter “Constitution”), Annex “Transitional Qualification Assessment”, and Article 65, par. 2 of Law No. 84/2016 “On the transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania” (hereinafter “Vetting Law” or VL).

I. Introduction

The assessee Afrim Shehu, serving as a prosecutor at the Tirana District Court, has undergone the re-evaluation process by the Independent Qualification Commission (hereinafter referred to as “IQC”) in accordance with Article 179/b, par. 3 of the Constitution and the provisions of the Vetting Law.

The IQC conducted its investigation based on three criteria: assets, background, and proficiency. After reviewing reports from auxiliary bodies and considering evidence obtained through the investigation process and submitted by the assessee, the IQC’s Adjudication Panel concluded the investigation. They then notified the assessee of their findings, shifted the burden of proof on certain issues, and requested explanations.

The hearing was held on 13.05.2024, and following deliberation as per Article 55, paragraph 5 of the Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law. The decision was announced publicly on 15th of May 2024.

The undersigned International Observers (hereinafter the “IOs”), having reviewed the case file and the results of the public hearing, believe that the evidence presented during the investigation justifies a review of the case by the Appeal Chamber.

II. Grounds for recommendation

Several issues were not properly assessed by the IQC, which renders the decision unclear. It does not appear to be based on the available evidence. It deviates from the standards typically held by the IQC in its current practice, and from the principles and guidelines established by the Special Appeal Chamber (hereinafter “AC”).

It is the IOs’ opinion that the assessee failed to adequately address the burden of proof regarding certain crucial findings resulting from the investigation. Furthermore, it is noted that the assessee’s attempts to rebut these findings were predominantly based on narratives lacking supporting evidence. Despite this, IQC accepted most of his explanations, drastically reduced the minus resulting from the investigation, and decided to confirm the assessee in duty.

Therefore, the IOs recommend that the Public Commissioners (hereinafter PCs) file an appeal against the IQC’s decision no. 762, dated 15th of May 2024, which confirmed Afrim Shehu in duty.

The IOs believe that a proper assessment of the evidence presented in the case, along with correct application of the relevant legal framework, would provide grounds for the AC to modify the IQC’s decision pursuant to article 66, para. 1.c of the Vetting Law.

Thus, the IOs request a judicial review of the entire case, particularly focusing on the following issues:

1. Assets assessment

It is our opinion that the assessee did not rebut certain investigative findings and the IQC did not provide clarity as to why, given the insufficient rebuttal, they reached a decision for a confirmation in office. The latter indicates a misinterpretation of the available evidence on crucial matters and insufficient reasoning of the decision.

A. Regarding the asset apartment in “ *** ** ” Street with surface 72.20.

Vetting Declaration: An apartment measuring 72.20 m² “ * ** ” Street,** registered in Cadastral Zone ***, property no. */** + ***, volume *, page *, Off-the-Plan Contract dated * ..5.2003, Sales Contract Rep. no. ***, Col. no. ***/**, dated * .7.2010. Paid in instalments as per the following money deposit slips: No. * , dated * .9.2003; No. **, dated * .9.2005 and No. ** dated * .5.2008.

Source of creation: Salary income as a Judicial Police Officer over the years and as a lawyer * .4.2002 - * .12.2003 and an amount of 10,041 EUR donated by *** ** (his brother), who lives in London, England, deposited into Afrim Shehu’s account no. ** - *** - * - ** at *** Bank, Tirana, on * .7.2003.

Price 4,000,000 ALL. Ownership 100%.

According to the administered documentation, the purchase price was paid as follows:

*First installment on * .09.2003 in the amount of 9.040 USD; second installment in the amount of 10.000 USD on * .09.2005; additional works in the amount of 1.270.000 ALL on * .10.2005 and 3.960 USD on * .05.2008; furnishing in the amount of 239.000 ALL (the date of payment is missing).*

Burden of proof: *“Apparently, the assessee made an inaccurate disclosure of the sources for the payment of the first instalment, disclosed in the Vetting declaration that the amount was transferred by his brother *** **, whereas the documents indicate that this was not the source feeding these payments.*

As per above, seemingly, the assessee lacked the financial capacity to settle the price of the apartment in the amount of ALL – 3,844,008.”

During the investigation and after the burden of proof, the assessee tried to justify the income used for the creation of this asset by altering and inflating the current sources declared as well as adding new sources never declared before. Herein below we will tackle each and one of the sources following his final submissions.

- Concerning the analysis of the sources of the first installment of the apartment the assessee claimed the following:

a) *Income during the time 2002-2003 as part of the law/notary office as a source for the apartment in .*** ** with 72.20 m² surface.*

About this income declared as source for the apartment .*** ** , the assessee specified in the **Vetting Declaration**: *“Income from working as a lawyer during **.4.2002 - **.12.2003, in the Law Firm at the address: “ *** ** ” street, Pall. */*, Tirana, NIPT *** , employment contract dated **.4.2002 and confirmation dated **.1.2017), the amount 2,518,333 ALL”.*

In the Declaration Before Assuming Office 2009, he disclosed as follows: *“From **.04.2002 to **.12.2003, a lawyer at Tirana Bar Chamber. Amount 2,500,000 ALL.”*

From the Social Insurance Institute Central Archive, it could be confirmed that the assessee earned as net salary 409,860 ALL in 2002 and 546,480 ALL in 2003. During the investigation and after the burden of proof, the assessee claimed that he worked as a lawyer at his brother's office¹ and provided services to the notary office of his sister-in-law. According to the assessee, in addition to the salaries that he earned from these offices, they also paid him 1.400.000 ALL in bonuses and overtime work corresponding to the 20% profit from the fees paid by clients to the office.

However, based on the documentation submitted by the assessee, the turnover declared by his brother's law office in 2002 amounted to 2.000.000 ALL and in 2003, 1.800.000 ALL. Therefore, even by pure math, the amount of 1.400.000 ALL in bonuses as 20% of the office profit cannot be justified by such turnover; hence, it is not plausible. In addition, there is no proof of payment of this amount, and even in the most favorable approach, there is still no proof of payment of taxes.

Regarding his claims that he benefited also from the notary office (sister-in-law) with the same contractual terms as the law office of his brother, this remains of a declarative nature and is not supported by documents since in this case they don't even have a contract.

In conclusion, regarding this source, from the investigation it could not be proven that the assessee benefited more than 956.340 ALL income as confirmed by the public authorities. Doing otherwise from what is reasoned above, would be conducting a financial analysis not based on income, the value and payment of which are proven through official documentation, and whose legality is demonstrated through the payment of tax obligations. The claim that the responsibility to pay taxes on this income lies with the employer does not affect an alternative interpretation of the law regarding the legitimate income. Therefore, in violation of constitutional, legal requirements and jurisprudence related to convincingly proving the value of income with documentation and its legality, in the

¹ In the employment contract provided by the assessee, it was specified that the employee shall benefit 20 % of the value paid by the clients defended by him and shall have other benefits above the salary (which was specified net amount as 55.000 ALL/ month) in overtime and holidays.

context of Article D, point 3 of the Annex to the Constitution and Articles 32, points 1; 49, point 4; and 3, point 19 of Law no. 84/2016.

b) *Gift of €10,041 by *** ** (his brother), who resides in London, England deposited on *.7.2003 to account Afrim Shehu's account No. ** -*** -* -* at *** Bank, Tirana.*

According to the statement of the account at *** Bank, provided by the assessee and attached to the Vetting Declaration, a transfer of €10,041 occurred on October *, 2003, from his account to a deposit account. This amount originated from a cash deposit of €19,000 made on July *, 2003. Out of this amount, €10,000 was invested as a term deposit on October *, 2003, which matured and was transferred to his account on February *, 2004. The remaining €9,000 stayed as a balance until February*, 2004, when the total amount of €19,100 was withdrawn from his account.

During the investigation, it was noted that this amount was withdrawn on February *, 2004, after the payment of the first installment (the payment slip was dated September *, 2003) for the apartment. In the 2004 PAD, the assessee did not declare cash sourced from this withdrawal, and thus, the amount could not serve as a source for the subsequent installments of the apartment. During the investigation, the assessee stated that the declaration of €10,041 by his brother *** ** as a gift was a mistake in the interpretation of the bank statement.

c) *Loan of 4.000\$ allegedly given in cash from *** ** in August 2003 that served as source for the payment of the first instalment.*

In the replies to second questionnaire, the assessee claimed that a loan taken in August 2003 from *** ** in the amount of 4.000 USD served partially for the payment of the first instalment, and the remaining part has as a source the income from work as a judicial police officer, as a lawyer, and from the bonuses and overtime, and a part of savings from his work in immigration.

After the burden of proof, the assessee claimed that the 4.000 USD loan was part of the bigger loan of 23.000 USD taken by his spouse from *** ** that the assessee declared and supported with notarial contract dated **.09.2005. According to his explanations, that is the reason why in October 2005 *** ** transferred 15.296 Euros instead of 23.000 USD because allegedly in August 2003, he had already lent him 4.000 USD.

Without analyzing whether the amounts match, or the fact that they are in different currencies - or the fact that in the loan contract there is no mention of amounts, their payments, and timeframe - it seems that the assessee is trying to fit different sources in different years in order to manipulate the financial analysis into a positive result.

As per above, the assessee changed the declaration about the source of the first installment of the apartment. This loan from *** *** was never disclosed in the Vetting Declaration or PAD over the years as a source for the asset whereas in the declaration before taking office the whole amount 23.000 USD was disclosed as a source for the other apartment in street “ *** *** ”; therefore, it should not have been taken into account in the analysis for the purchase of the apartment in *** *** St.

d) *Income from immigration in Greece and Ponzi schemes*

The assessee explains that from 1993 to 1995 he was an immigrant in Greece and declared in the 2009 PAD an amount of 2,000,000 ALL. He did not declare this income in the Vetting Declaration due to a lack of documentation. Since he cannot prove this income, it will not be considered in the financial analysis.

Regarding income from the pyramid schemes, the assessee stated: "I was able to secure letter no. ** dated March **, 2024, issued by Borrowing Companies in Administration, from which it appears that in the company '*** ' sh.p.k., I deposited a part of my savings as soon as I returned from immigration and subsequently benefited from the amount of 873,113 ALL."

He provided as evidence an attestation confirming that he deposited 730,000 ALL at the former pyramid scheme company in 1996 and withdrew 873,113.3 ALL in 1997. It was noted that this source was only brought up in the latest submissions of the assessee. However, the income received amounts to 143,113.3 ALL (withdrawals minus deposits) rather than the claimed 873,113.3 ALL. Furthermore, the funding for the placement came from immigration-related income, the legitimacy of which has not been proven.

As a result of the above the analysis of the sources claimed for the payment of the first installment of the apartment, the financial analysis shows the following:

Assets up to 09.10.2003	4,298,030
Apartment *** *** 1st installment 9040 USD dt. **.10.2003	982,558
Liquidities balance on * .10.2003	3,315,472
Income	1,266,829
Salaries as a JPO * .1999- * .12.2000	431,986
Interest income from deposits *** Bank	15,938
Donation from his brother	-
Income as a lawyer during * .04.2002- **.12.2003	818,905

<i>Expenses</i>	426,783
Living expenses	426,783 ²
<i>Difference</i>	(3,457,984)

It was noted that the assessee had a balance of liquid assets at the end of 2003 amounting to 3,349,749 ALL, created by cash deposits of 19,000 EUR and 3,400 USD into his *** Bank account during 2003. These amounts were withdrawn in 2004 but were not declared as cash savings in the 2004 Declaration. Only an amount of 10,041 EUR was declared as a source for the apartment in “*** *** ” (analyzed in paragraph b above). Therefore, no amount should be carried forward to cover other expenses or investments that occurred from 2005 to 2009.

Considering that the assessee changed the declaration about the source (a donation of 10,041 EUR from his brother) and claimed a previously undisclosed loan of 4,000 USD from *** *** as a source for this asset, the alleged loan shall not be considered in the financial analysis of the first installment.

After examining the assessee’s submissions, we conclude:

- The assessee lacks financial sources for the payment of the first installment in the entire amount of 9,040 USD.
- The assessee changed the declaration about the source (a donation of 10,041 EUR from his brother) and claimed a loan of 4,000 USD from *** *** not disclosed in the Vetting Declaration or annual declarations.
- The income from Ponzi schemes was never declared by the assessee and even if considered, the profit received is only 143,113.3 ALL, instead of 873,113 ALL as considered by the IQC.
